# KONSULTIM ME PUBLIKUN

## “ZGJERIMI I KAPACITETIT TE LENDFILLIT TE MBETJEVE URBANE (PIKA 13), PAJISUR ME LEJE MJEDISI TIPI A (PN-0762-08-2021), ZONA E TRAJTIMIT TE MBETJEVE TIRANE (Z.T.M.T)"

## SHARRE, NJ.A. VAQARR, BASHKIA TIRANE

**Zhvillues: “INTEGRATED ENERGY BV SPV” Sh.p.k., me NIPT L72031013B**

**Janar, 2025**

# PASQYRA E LENDES


HYRJA ..........

Pershkrimi i projektit ..........

A1. Qellimi i zhvillimit te projektit .......... 7

A2. Vendndodhja ..........

A3. Siperfaqja dhe kapaciteti ..........

1. PERSHKRIMI I MBULESES BIMORE TE ZONES NE STUDIM ..........

1.1. Mbulesa bimore (flora) ..........

• Gjelberimi dhe rehabilitimi i mjedisit ne Zonen e Trajtimit te Mbetjeve Tirane ..........

1.2. Fauna ..........

1.3. Zonat e Mbrojtura dhe Monumentet e Natyres ..........

1.4. Pershkrimi i mjedisit ..........

1.4.1. Gjeologjia ..........

1.4.2. Gjeomorfologjia ..........

1.4.3. Tokat ..........

1.4.4. Klima ..........

2. INFORMACION PER PRANINE E BURIMEVE UJORE, NE SIPERFAQEN E KERKUAR NGA PROJEKTI DHE NE AFERSI TE TIJ ZBATOHET PROJEKTI ..........

2.1. Ujerat siperfaqesore ..........

2.2. Ujerat nentokesore ..........

3. INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TE MUNDSHME NEGATIVE NE MJEDIS TE PROJEKTIT ..........

3.1. Hyrje ..........

3.2. Permbledhje e ndikimeve potenciale mjedisore gjate pergatitjes per fazen e operimit dhe gjate fazes se operimit/ funksionimit te qelizes shtese te lendfillit te mbetjeve urbane ..........

3.3. Ndikimet ne cilesine e ajrit ..........

3.4. Ndikimet ne toke ..........

3.5. Ndikimet ne burimet ujore (siperfaqesore dhe nentokesore) ..........

3.6. Ndikimet ne biodiversitet ..........

3.7. Ndikimet nga gjenerimi i zhurmave ..........

3.8. Ndikimet mbi popullsine lokale ..........

4. PERSHKRIM PER SHKARKIMET E MUNDSHME NE MJEDIS ..........

4.1. Ujerat e ndotura ..........

4.2. Gaze dhe pluhur ..........

4.3. Zhurma dhe vibrime ..........

4.4. Prodhimi i mbetjeve ..........

5. INFORMACION PER KOHEZGJATJEN E MUNDSHME TE NDIKIMEVE NEGATIVE TE IDENTIFIKUARA ..........

7. MUNDESIA E REHABILITIMIT TE MJEDISIT TE NDIKUAR DHE MUNDESINE E KTHIMIT TE MJEDISIT TE NDIKUAR TE SIPERFAQES NE GJENDJEN E MEPARSHME ..........

8. MASAT E MUNDSHME PER SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS ..........

8.1. MASAT ZBUTESE PER NDIKIMET NEGATIVE NE MJEDIS ..........

8.1.1. MASAT ZBUTESE PER REDUKTIMIN E NDIKIMEVE NE AJER ..........

8.1.2. MASAT ZBUTESE PER REDUKTIMIN E NDIKIMEVE NE TOKE ..........

8.1.3. MASAT ZBUTESE PER NDIKIMET NGA GJENERIMI I ZHURMAVE ..........

8.1.4. MASAT ZBUTESE PER REDUKTIMIN E NDIKIMEVE NE UJERAT SIPERFAQESORE ..........

8.1.5. MASAT ZBUTESE PER NDIKIMET NGA MBETJET ..........

8.2. PLANI I MONITORIMIT MJEDISOR ..........

8.3. INFORMACIONI LIDHUR ME ZBATIMIN E KUSHTEVE TE LEJES SE MJEDISIT TE TIPIT A ME PN-0762-08-2021 ..........

# HYRJA

## Pershkrimi i projektit

Ky raport do te paraqese nje informacion te projektit qe do te realizohet, ndikimet pozitive dhe negative ne mjedis dhe masat qe zhvilluesi do te marre per zbatimin e kritereve te nevojshme per mbrotjen dhe menaxhimin sa me racional te mjedisit.

Perkatesisht per piken 13 te Zones se Trajtimit te Mbetjeve Tirane (Z.T.M.T.), lendfill i mbetjeve urbane, eshte i pajisur me:

- Vendim per VNM paraprake me nr. 2372 prot., date 08.05.2019, nr. identifikimi 384, vendimi 23 per te zhvilluar projektin “Landfilli i mbetjeve te ngurta urbane me kapacitet nen 50 ton ne dite (pika 13).
- Leje Mjedisi te tipit A me nr. 5879 prot., date 19.08.2021, nr. identifikimit te Lejes 3703, K.Nr. 34 dhe PN-0762-08-2021.

dhe:

a. referuar nenit 8, germa ‘b’ te ligjit nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis”, te ndryshuar, ku citohet perkatesisht:

   *“Projektet qe i nenshtrohen vleresimit paraprak te ndikimit ne mjedis jane:*

   *b) cdo ndryshim a shtese ne projektet e listuara ne shtojcen I apo II, te licencuara paraprakisht, qe mund te shkaktoje efekte te rendesishme negative mbi mjedisin*”

b. referuar percaktimeve te KREU V “*Ndryshime ne funksionimin e instalimeve te tipit A dhe te tipit B dhe rishikimi i kushteve te lejeve ekzistuese*”, SEKSIONI 1 ”*Ndryshimi i propozuar ne funksionimin e nje instalimi te tipit A dhe te tipit B*” te VKM nr. 419, date 25.06.2014 “Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A, B dhe C, per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit, si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja”, te ndryshuar

Zhvilluesi “Integrated Energy BV SPV” Sh.p.k. ka kryer proceduren paraprake te VNM per projektin “Zgjerimi i kapacitetit te lendfillit te mbetjeve urbane (pika 13), pajisur me Leje Mjedisi tipi A (PN-0762-08-2021), Zona e Trajtimit te Mbetjeve Tirane (Z.T.M.T)" dhe eshte pajisur me Vendim per VNM paraprake (AN240120240001, më 08.03.2024, Komisioni 32) dhe me leje ndertimi: Vendim KKT Nr.12, Dt. 02.04.2024, Objekti: “Zgjerim i kapacitetit te depozitimit te mbetjeve te ngurta urbane, zona 13¹, me vendodhje ne Bashkine Tirane, me zhvillues shoqerine Integrated Energy BV SPV”.

Pas perfundimit te ndertimit te qelizes per Zgjerimin e kapacitetit te lendfillit te mbetjeve urbane (pika 13), pajisur me Leje Mjedisi tipi A (PN-0762-08-2021) **do te vijoje me proceduren per ndryshimin e kushteve te Lejes se Mjedisit te tipit A me PN-0762-08-2021, me nr. 5879 prot., date 19.08.2021, nr. identifikimit te Lejes 3703, K.Nr. 34, per instalimin “Landfill i mbetjeve (D1) duke perjashtuar landfillin**

**e mbetjeve inerte" qe kjo shoqeri posedon per piken 13 "LANDFILLI I MBETJEVE TE NGURTA URBANE", me qellim qe kesaj leje mjedisi t'i shtohet edhe kapaciteti i qelizes shtese "QELIZA SHTESE E OBJEKTIT 13 (LANDFILLI I MBETJEVE TE NGURTA URBANE)"**, sipas percaktimeve te VKM nr. 419, date 25.06.2014 "Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A, B dhe C, per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit, si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja", te ndryshuar, perkatesisht tek KREU V "Ndryshime ne funksionimin e instalimeve te tipit A dhe te tipit B dhe rishikimi i kushteve te lejeve ekzistuese", SEKSIONI 1 "Ndryshimi i propozuar ne funksionimin e nje instalimi te tipit A dhe te tipit B".

Ne kete siperfaqe ku propozohet te zhvillohet zgjerimi i kapacitetit shoqeria "Integrated Energy BV SPV" Sh.p.k. ka zhvilluar punime pergjate periudhes 2019-2020, ku ka gerrmuar nje grope, e cila eshte veshur me argjile. Per kete arsye gjate inspektimit te kryer date 08.02.2024 nga Inspektoriati i Mbrojtjes se Territorit (IMT) te Njesise Vaqarr eshte konstatuar kundervajtja "Punime ndertimi pa lejen perkatese duke kryer germime dhe hapjen e nje grope". Ne baze te ketij procesverbali eshte vendosur gjoba respektive me date 16.02.2024. Kjo gjobe e IMT eshte shlyer nga shoqeria "Integrated Energy BV SPV" Sh.p.k. me date 19.02.2024.

**Me poshte jane paraqitur disa fotografi te qelizes shtese gjate punimeve.**







**Theksohet se projekti i propozuar qe konsiston ne zgjerimin e kapacitetit te lendfillit te mbetjeve te ngurta urbane (pika 13) pajisur me Leje Mjedisi te tipit A (PN-0762-08-2021) parashikohet edhe ne kontraten koncensionare nr. 6021 Rep., nr. 2893 Kol., date 21.08.2017 "Per ndertim landfilli, inceneratori dhe rehabilitim i venddepozitimit ekzistues Tirane dhe prodhimin e energjise elektrike", perkatesisht eshte ne LOTIN B te projekti.**

## A1. Qellimi i zhvillimit te projektit

Shoqeria “Integrated Energy BV SPV” Sh.p.k. eshte zbatuese e Kontrates Koncensionare nr. 6021 Rep., nr. 2893 Kol., date 21.08.2017 lidhur me Ministrine e Mjedisit “Per ndertim landfilli, inceneratori dhe rehabilitim i venddepozitimit ekzistues Tirane dhe prodhimin e energjise elektrike”, Zona e Trajtimit te Mbetjeve Tirane (Z.T.M.T.). Siperfaqja objektit, si dhe e gjithe Zona e Trajtimit te Mbetjeve Tirane (Z.T.M.T.) eshte pjese e territorit te administruar nga Bashkia Tirane, Njesia Administrative Vaqarr, Zona Kadastrale nr. 3321.

Qellimi i pergatitjes per operim qelizes shtese per zgjerimin e kapacitetit te lendfillit te mbetjeve urbane te pajisur me Leje Mjedisi te tipit A (PN-0762-08-2021) dhe te operimit te objektit ne studim eshte:

- Te minimizoje streset ne mjedis dhe ne radhe te pare ne elementet prioritare si ruajtja e tokes, kontrolli i zhurmave, dhe ruajtja e cilesise se ujit dhe ajrit;
- Te ruaje ose rehabilitoje mjedisin natyror permes elementeve te reja te nderhyrjes pozitive, punimeve te vecanta ne kuader te projektit ose paralel me te, te cilet sigurojne vijueshmerine e qendrueshme te mjedist biologjik duke perfshire faunen dhe floren ne mjediset perreth zones se marre ne konsiderate.

Aktualisht mbetjet e ngurta urbane te Qarkut Tirane dhe te Qarkut Durres, te cilat nuk mund te riciklohen, depozitohen ne lendfillin e mbetjeve urbane (Pika 13), te pajisur me Leje Mjedisi te tipit A (PN-0762-08-2021), te Z.T.M.T, te cilit i eshte ezauruar kapaciteti depozitues dhe do te nise fazen e kapsulimit te qelizes. Qeliza shtese konsiston ne **zgjerimin e kapacitetit te depozitimit te lendfillit te mbetjeve urbane (pika 13) te pajisur me Leje Mjedisi te tipit A (PN-0762-08-2021), ku do te depozitohen ato mbetje te ngurta urbane, te cilat nuk mund te riperdoren dhe as nuk mund te riciklohen, pra qe dalin nga kapanoni i selektimit te mbetjeve te treguar edhe ne figuren 1.** Procesi i perzgjedhur eshte ai asgjesim/ depozitimit ne lendfill te nje pjese mbetjeve te ngurta urbane, projekt i cili do kontribuoje ne permiresimin e cilesise se mjedisit dhe ruajtjen e tij, si rezultat i minimizimit te ndikimeve ne mjedis, nepermjet uljes se volumit te mbetjeve ne territorin e Qarkut Tirane dhe Qarkut Durres.

Lendfilli i mbetjeve urbane (Pika 13) eshte i pajisur me Lejen e Mjedisit te Tipit A me nr. 5879 prot., date 19.08.2021, nr. i identifikimit te Lejes 3703, K.Nr. 34.

Per shkak te volumit te mbetjeve te depozituara ne lendfillin e mbetjeve urbane (pas procesit te selektimit dhe presimit te tyre), ky lendfill eshte drejt perfundimit te fazes se operimit dhe do te nise faza e kapsulimit te kesaj qelize, sikurse verehet edhe ne figuren 1 me siper.

Ne menyre qe te vijohet me menaxhimin e mbetjeve urbane te Qarkut Tirane dhe Qarkut Durres, shoqeria “Integrated Energy BV SPV” Sh.p.k. propozon qe depozitimi i mbetjeve urbane te vijoje ne **qelizen shtese per zgjerimin e kapacitetit te lendfillit te mbetjeve urbane (pika 13) te pajisur me Leje Mjedisi te tipit A (PN-0762-08-2021), pra per zgjerimin e kapacitetit te lendfillit ekzistues te mbetjeve urbane.**

Theksojme, se infrastruktura mbeshtetese per operimin e lendfillit te mbetjeve urbane eshte e ndertuar dhe se bashku me lendfillin e mbetjeve urbane (Pika 13), edhe dy peshoret dhe kapanoni i selektimit te mbetjeve jane te pajisur me Lejen e Mjedisit te Tipit A me nr. 5879 prot., date 19.08.2021, nr. i identifikimit te Lejes 3703, K.Nr. 34. Strukturat paraqiten me poshte:



**Figura 1 Peshore e mbetjeve**



**Figura 2 Kapanoni i selektimit te mbetjeve**



**Figura 3 Kapanoni i selektimit (diferencimit) te mbetjeve**

Per shkak te volumit te mbetjeve te depozituara ne lendfillin e mbetjeve urbane (pas procesit te selektimit dhe presimit te tyre), ky lendfill eshte drejt perfundimit te fazes se operimit. Ne menyre qe te vijohet me menaxhimin e mbetjeve urbane te Qarkut Tirane dhe te Qarkut Durres, shoqeria “Integrated Energy BV SPV” Sh.p.k. propozon qe depozitimi i mbetjeve urbane te vijoje ne nje qelize shtese te lendfillit te mbetjeve urbane per zgjerimin e kapacitetit te lendfillit ekzistues te mbetjeve urbane, te pajisur me Leje Mjedisi te tipit A (PN-0762-08-2021).

## A2. Vendndodhja

Siperfaqja ku qeliza shtese te lendfillit te mbetjeve urbane per zgjerimin e kapacitetit te lendfillit ekzistues te mbetjeve urbane, te pajisur me Leje Mjedisi te tipit A (PN-0762-08-2021), eshte pjese e Zones se Trajtimit te Mbetjeve Tirane, Bashkise Tirane, Njesia Administrative Vaqarr, Zona Kadastrale nr. 3321.

**Tabela 1 Koordinatat sipas sistemit KRJGSH/Gauss-kruger Zone 4**

| | GAUSS KRUGER | | KRGJSH | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **X** | **Y** | **X** | **Y** |
| 1 | 480660 | 4573248 | 480609 | 4572987 |
| 2 | 480641 | 4573227 | 480616 | 4572981 |
| 3 | 480597 | 4573204 | 480629 | 4572978 |
| 4 | 480551 | 4573156 | 480641 | 4572981 |
| 5 | 480544 | 4573149 | 480647 | 4572987 |
| 6 | 480542 | 4573140 | 480711 | 4573072 |
| 7 | 480542 | 4573132 | 480721 | 4573083 |
| 8 | 480544 | 4573127 | 480788 | 4573147 |




**Figura 4 Planimetri e qelize shtese te lendfillit te mbetjeve urbane per zgjerimin e kapacitetit te lendfillit ekzistues te mbetjeve urbane te pajisur me Leje Mjedisi te tipit A (PN-0762-08-2021)**




Figura 5 Planvendosja e qelizes shtese per zgjerimin e kapacitetit te lendfillit te mbetjeve urbane te pajisur me Leje Mjedisi te tipit A (PN-0762-08-2021) ne Z.T.M.T.




**Figura 6 Planimetria e qelizes shtese per zgjerimin e kapacitetit te lendfillit te mbetjeve urbane te pajisur me Leje Mjedisi te tipit A (PN-0762-08-2021)**




**Figura 7 Harta topografike e qelizes shtese per zgjerimin e kapacitetit te lendfillit te mbetjeve urbane te pajisur me Leje Mjedisi te tipit A (PN-0762-08-2021)**

- **Zona Kadastrale**

Territori ku ndodhet Zona e Trajtimit te Mbetjeve Tirane eshte ne pronesi shtet dhe ben pjese ne Zona Kadastrale nr. 3321 , Indeksi Harte K-34-100 (25-C), Sharre, Vaqarr, Tirane. Ish-pronaret private jane shpronesuar me ane te:

- VKM Nr. 811, date 26.12.2018 "Per shpronesimin per interes publik, te pronareve te pasurive te paluajtshme, prone private, qe preken nga realizimi i projektit "Per ndertimin e landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimin e venddepozitimeve ekzistuese Tirane dhe prodhimin e energjise elektrike", Tirane, dhe

- VKM Nr. 1154, date 24.12.2020, "Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 811, date 26.12.2018, te Keshillit te Ministrave, "Per shpronesimin per interes publik te pronareve te pasurive te paluajtshme, prone private, qe preken nga realizimi i projektit 'Per ndertimin e landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimin e venddepozitimeve ekzistuese Tirane dhe prodhimin e energjise elektrike', Tirane".

### A. Siperfaqja dhe kapaciteti

- **Siperfaqja**

**Siperfaqja e qelizes shtese** te lendfillit te mbetjeve urbane per zgjerimin e kapacitetit te lendfillit ekzistues te mbetjeve urbane te pajisur me Leje Mjedisi te tipit A (PN-0762-08-2021) eshte **35415.1 $m^2$**, nderkohe qe siperfaqja e lendfillit ekzistues (pika 13) eshte 17913 $m^2$.

Siperfaqja e lendfillit ekzistues te mbetjeve urbane (pika 13): 17913 $m^2$

**Siperfaqja e qelizes shtese per zgjerimin e kapacitetit te lendfillit te mbetjeve urbane (per te cilen po behet ky aplikim): 35415.1 $m^2$**

**Siperfaqja totale (qeliza ekzistuese + qeliza shtese) qe do te perfshihet tek leja e mjedisit e rishikuar: 53328.1 $m^2$**

- **Kapaciteti i depozitimit te mbetjeve urbane**

**Kapaciteti i qelizes shtese per zgjerimin e kapacitetit te lendfillit te mbetjeve urbane (per te cilen po behet ky aplikim): 28.728 ton mbetje/ dite.**

**Nga sa me siper, qeliza shtese se bashku me qelizen ekzistuese te lendfillit te mbetjeve urbane te pajisur me Leje Mjedisi te tipit A (PN-0762-08-2021) do te kene nje kapacitet depozitues 28.728 ton mbetje / dite**, te cilat do te dalin pas procesit te seleksionimit/ diferencimit te mbetjeve re riciklueshme dhe pas vleresimit qe keto mbetje nuk jane te pershtatshme per riperdorim apo riciklim.

- **Pershkrim i aktivitetit gjate fazes se operimit te qelizes shtese per zgjerimin e kapacitetit te lendfillit te mbetjeve urbane te pajisur me Leje Mjedisi te tipit A (PN-0762-08-2021)**

Mbetjet hyjne ne Zonen e Trajtimit te Mbetjeve Tirane, peshohen ne peshoret perkatese dhe dergohen ne kapanonin e diferencimit/selektimit, veprimtari qe jane pjese e Lejes se Mjedisi te tipit A (PN-0762-08-2021). Me pas mbetjet hidhen ne transportier (zinxhir transportues) dhe i nenshtrohen selektimit manual dhe gjysem automatik, ku vecohen mbetjet e riciklueshme dhe ato qe mund te lendfillohen (depozitohen ne lendfill te mbetjeve urbane te ngurta.

Brenda kapanonit ka dy presa qe kryejne kompaktimin e mbetjeve, njera prese eshte per mbetjet e riciklueshme, ku kompaktohen vecmas ne kubike permasa 1.1 m x 1.1 m, plastika, mbetjet metalore, letra/kartoni, etj., te cilat magazinohen brenda kapanonit te selektimit dhe do te sherbejne si lende e pare per industrite ricikluese. Ndersa presa e dyte sherben per mbetjet e perziera urbane, te cilat kompaktohen ne kubik me permasa 1.1 m x 1.1 dhe me ane te automjeteve transportues keto kubike mbetjesh depozitohen ne lendfill ne menyre te rregullt, me qellim magazinimin e tyre dhe me mundesi riperdorimin e tyre si lende e pare per impiantin e trajtimit te mbetjeve per prodhimin e energjise, me qellim edhe uljen e vellimit te mbetjeve ne lendfill dhe zgjatjen e jetegjatesise se tij.





















**Figura 8 Foto nga mbetjet e riciklueshme te presuara**

Sipas VKM nr. 452/ 2012 “Per lendfillet e mbetjeve”, te ndryshuar, kreu VIII “Procedurat e pranimit te mbetjeve ne lendfill”, pika 12, operatori, para pranimit te mbetjeve ne vendin e lendfillit, kryen procedurat e meposhtme te hyrjes:

a. kontrollon dokumentacionin shoqerues te mbetjeve;
b. inspekton me sy mbetjet ne hyrje te vendit te lendfillit dhe ne piken e depozitimit;
c. verifikon perputhshmerine e mbetjeve me pershkrimin e dhene ne dokumentacionin e dorezuar nga mbajtesi;
d. kur ne zbatim te kerkesave te seksionit 1.3 te aneksit II, per verifikimet ne vend, merren dhe analizohen mostra perfaqesuese, marrja e mostrave dhe ruajtja e tyre dhe e rezultateve te analizave behet ne perputhje me aneksin II, seksioni 3. Keto mostra ruhen per, te pakten, 1 (nje) muaj;
e. leshon dokument me shkrim per marrjen e cdo dergese te pranuar ne vend;
f. ploteson regjistrin perkates me sasite dhe karakteristikat e mbetjeve te depozituara, duke shenuar origjinen, daten e dorezimit, identitetin e gjeneruesit ose te grumbulluesit te mbetjeve bashkiake. Ky informacion i vihet ne dispozicion Agjencise Kombetare te Mjedisit, sipas afateve te percaktuara.

Skema permbledhese e veprimtarise se instalimit paraqitet ne vijim:




**Figura 9 Skema permbledhese e aktivitetit qe do te zhvillohet gjate fazes se operimit te qelizes shtese per zgjerimin e kapacitetit te lendfillit te mbetjeve urbane**

Menaxhimi i mbetjeve qe do te pranohen per depozitim ne qelizen shtese te lendfillit te mbetjeve urbane per zgjerimin e kapacitetit te lendfillit ekzistues te mbetjeve urbane

do te kryhet sipas percaktimeve te Lejes se Mjedisit te Tipit A (PN-0762-08-2021) me te cilen eshte i pajisur lendfilli i mbetjeve urbane (cituar ne paragrafet e mesiperm), konkretisht si me poshte:

**Tabela 4.1.2 Asgjesimi/ trajtimi i mbetjeve jo te rrezikshme**

| Mbetja | Numri i katalogut | Trajtim i metejshem ne vendndodhje | Riperdorimi, riciklimi ose trajtimi ne vendndodhje | Metoda e asgjesimit/ trajtimit ne vendndodhje |
|---|---|---|---|---|
| Lengje nga trajtimi anaerobik I mbetjeve urbane | 19 06 03 | Impianti i Trajtimit te ujerave | | Llumrat e gjeneruara nga impianti trajtimit te ujerave nga lendfilli te grumbullohet,transportohen dhe asgjesohen nga operator te licensuar |
| Mbetje te tretshme nga trajtimi anaerobik i mbetjeve urbane | 19 06 04 | Impianti i Trajtimit te ujerave | | Llumrat e gjeneruara nga impianti trajtimit te ujerave nga lendfilli te grumbullohet,transportohen dhe asgjesohen nga operator te licensuar |
| Rrjedhje nga landfillet, te tjera nga ato te permendura ne 19 07 02 | 19 07 03 | Impianti i Trajtimit te ujerave | | Llumrat e gjeneruara nga impianti trajtimit te ujerave nga lendfilli te grumbullohet,transportohen dhe asgjesohen nga operator te licensuar |
| Mbetje te biodegradueshme nga kuzhinat dhe mensat | 20 01 08 | Operacionet e asgjesimit D1 Lendfill | | |
| Mbetjet nga pastrami i oxhaqeve | 20 01 41 | Operacionet e asgjesimit D1 Lendfill | | |
| Mbetje te biodegradueshme | 20 02 01 | Operacionet e asgjesimit D1 Lendfill | | |
| Mbetje te tjera te pabiodegradueshme | 20 02 03 | Operacionet e asgjesimit D1 Lendfill | | |
| Mbetjet e perziera urbane | 20 03 01 | Operacionet e asgjesimit D1 Lendfill | | |
| Mbetje nga tregjet | 20 03 02 | Operacionet e asgjesimit D1 Lendfill | | |

| **Tabela 4.1.2 Asgjesimi/ trajtimi i mbetjeve jo te rrezikshme** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Mbetja** | | **Numri i katalogut** | **Trajtim i metejshem ne vendndodhje** | **Riperdorimi, riciklimi ose trajtimi ne vendndodhje** | **Metoda e asgjesimit/ trajtimit ne vendndodhje** |
| Mbetje nga pastrami i rrugeve | | 20 03 03 | Operacionet e asgjesimit D1 Lendfill | | |
| Mbetjet te vellimshme | | 20 03 07 | Operacionet e asgjesimit D1 Lendfill | | |
| Mbetjet urbane te paspecifikuara | | 20 03 99 | Operacionet e asgjesimit D1 Lendfill | | |
| **Operacionet e diferencimit te mbetjeve te ngurta urbane R12** | | **Diferencimi i mbetjeve te ngurta urbane me ane te operacioneve R12** | | **Riperdorimi , riciklimi ose trajtimi ne vendndodhje** | **Metoda e asgjesimit/trajtimit jashte vendndodhjes** |
| **Mbetja** | **Numri i katalogut** | **Mbetja (Rikategorizuar)** | **Numri i katalogut (Rikategorizuar)** | | |
| Mbetje te perziera urbane<br><br>Mbetje te vellimshme | 20 03 01<br><br>20 03 07 | Leter dhe karton | 20 01 01 | | Ruajtje/magazinim, grumbullim, transportim, riciklim dhe trajtim nga operatore te licensuar |
| | | Qelq | 20 01 02 | | Ruajtje/magazinim, grumbullim, transportim, riciklim dhe trajtim nga operatore te licensuar |
| | | Veshjet | 20 01 10 | | Ruajtje/magazinim, grumbullim, transportim, riciklim dhe trajtim nga operatore te licensuar |
| | | Tekstilet | 20 01 11 | | Ruajtje/magazinim, grumbullim, transportim, riciklim dhe trajtim nga operatore te licensuar |
| | | Mbetje druri te tjera nga | 20 01 38 | | Ruajtje/magazinim, grumbullim, transportim, riciklim dhe trajtim nga operatore te licensuar |

| Tabela 4.1.2 Asgjesimi/ trajtimi i mbetjeve jo te rrezikshme | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Mbetja** | | **Numri i katalogut** | **Trajtim i metejshem ne vendndodhje** | **Riperdorimi, riciklimi ose trajtimi ne vendndodhje** | **Metoda e asgjesimit/ trajtimit ne vendndodhje** |
| | | ato te permendura ne 20 01 37 | | | |
| | | Plastikat | 20 01 39 | | Ruajtje/magazinim, grumbullim, transportim, riciklim dhe trajtim nga operatore te licensuar |
| | | Metalet | 20 01 40 | | Ruajtje/magazinim, grumbullim, transportim, riciklim dhe trajtim nga operatore te licensuar |

**Theksojme se keto tipologji mbetjesh do te menaxhohen edhe gjate fazes se operimit te qelizes shtese per zgjerimin e kapacitetit te lendfillit ekzistues te mbetjeve urbane te pajisur me Leje Mjedisi te tipit A (PN-0762-08-2021). Mbetjet qe do te pranohen ne qelizen shtese te lendfillit jane te njejta me mbetjet e listuara ne tabelen 4.1.2 “Asgjesimi/ trajtimi i mbetjeve jo te rrezikshme” te Lejes se Mjedisit te tipit A (PN-0762-08-2021) me te cilen eshte i pajisur lendfilli i mbetjeve urbane (pika 13), pra nuk ka ndryshime ne teknologjine e menaxhimit te mbetjeve urbane apo tipologjine e mbetjeve.**

# 1. PERSHKRIMI I MBULESES BIMORE TE ZONES NE STUDIM

Ne zonen e perzgjedhur nuk ka ndonje lloj ose specie flore apo faune qe mbrohet me status te vecante. Zona ka qene e shfrytezuar si venddepozitim i mbetjeve te Bashkise Tirane qe ne fund te viteve 1980, ndaj bimesia nuk ka qene e zhvilluar, sikurse ilustrohet ne harten ne vijim (burimi: ASIG). Pas fillimit te implementimit te projektit Zones se Trajtimit te Mbetjeve Tirane, ne kete territor jane krijuar nje sere habitatesh te gjelberuara qe paraqiten ne paragrafet ne vijim.



**Figura 10 Mbulesa bimore e zones se projektit**

## 1.1. Mbulesa bimore (flora)

Zona ne vleresim dominohet nga habitati i tokave me bar / djerre dhe habitati i perroit, te cilet paraqiten teper te degraduar dhe me mbulim te vogel te bimesise si rrjedhoje e ndotjes se larte ne toke, per shkak te vendodhjes ne afersi te vendepozitimit aktual te mbetjeve. Per rrjedhoje, dhe diversiteti i llojeve shtazore qe strehoen ne to eshte teper i vogel. Megjithate, zona ne vleresim kufizohet me habitate te tjera, qe luajne rol te rendesishem duke shtuar vleren botanike dhe ekologjike ne teresi te te gjithe zones perreth. Permendim keshtu, ujembledhesat ne afersi te Zones se Trajtimit te Mbetjeve Tirane, mozaikun e tokave bujqesore prane fshatit Damjan-Fortuzaj dhe atyre prane fshatit Sharre, tokat me bar, dhe habitatin e perroit. Lloje te ndryshme faunistike qe jane te zakonshem ne keto mjedise mund te vizitojne zonen e studimit ne kerkim te ushqimit ose thjesht ta perdorin ate si rruge kalimi.

Habitati i tokave djerre eshte mjaft i perhapur ne zonen e studimit dhe zhvillohet si rezultat i impaktit njerezor afatgjate. Ai shtrihet kryesisht me kundrejtim me Jugu dhe me pjerresi qe varion deri ne 30%. Terrenet e pjerrta qe jane ne ndikimin e erozionit

te vazhdueshem, dhe kane mbulim te vogel te bimesise. Si rrjedhoje, keto habitate nuk mbeshtesin biodiversitet te larte. Lloje te zakonshme qe i japin fizionomine ketij formacioni bimor perfshijne: Lepjeten (*Rumex acetosa*), Rrodhen (*Arctium lappa*), Keputje arash (*Equisetum arvense*), Mugashtra (*Dittrichia viscosa*), Cikorja e eger (*Cichorium intybus*), Minuerin e bardhe (*Chenopodium album*), Serice muresh (*Alyssum murale*), Manaferra (*Rubus ulmifolius*), Grami (*Cynodon dactylon*), Kamele rumenise (*Camelina rumelica*), Terfili zvarrites (*Trifolium repens*), Mellaga pyjore (*Malva sylvestris*), Lepushke (*Verbascum pulverulentum*), Gjemb gomari (*Cirsium vulgare*), bari mureve (*Parietaria officinalis*), Ushqera (*Echium italicum*), etj.

Habitati i perroit qe derdhet ne Erzen, ka shtrirje me kundrejtim nga Perendimi dhe pjesa me e madhe e tij eshte e mbuluar nga bimesi barishtore dhe shkurrore. Llojet me te zakonshme perfshijne: Shelgjet (*Salix alba, Salix purpurea*), marinen lulevogel (*Tamarix parviflora*), rrapin (*Platanus orientalis*), Manaferren (*Rubus ulmifolius*), Kelkazen (*Arum italicum*), Rudithin dy-kallizor (*Brachypodium sylvaticum*), Keputjen shqiponje (*Pteridium aquilinum*), Kulpren e eger (*Clematis vitalba*), Telishin (*Dactylis glomerata*), Bukederrin (*Cyclamen hederifolium*), etj. Keto habitate per shkak te perhapjes se kufizuar ne vendin tone dhe diversitetit te larte te llojeve qe strehojne, nje pjese e te cilave kane status te vecante kombetar, kane vlera e larte ekologjike. Persa i perket gjendjes se ketij habitati ne zonen e vleresimit, ai paraqitet i fragmentuar dhe i degraduar per shkak te nderhyrjeve dhe aktiviteteve te ndryshme qe zhvillohen pergjate shtratit te perroit.

Ne afersi te zones se studimit gjenden dhe kanale ujore kullimi, ne te cilat instalohen formacione te fragmentuara te kallamishtes (*Phragmites australis*), te shoqeruara me lloje te tjera si Shevari gjethengushte (*Typha angustifolia*), zuba (*Scirpus lacustris*), Kelkaza e ujit (*Alisma plantago-aquatica*), Mendra e ujit (*Mentha aquatica*), Keputje arash (*Equisetum arvense*), etj. Vlera e bimesise se ketij habitati eshte pergjithesisht e ulet, per shkak te diversitetit te ulet te llojeve bimore dhe mungeses se specieve qe konsiderohen te jene te rralla ne kontekstin lokal ose kombetar. Kjo, pasi llojet bimore te tij jane te zakonshme ne te gjithe vendin.

Tokat bujqesore, megjithese nuk kane lidhje te drejtperdrejte zonen e projektit, luajne rol te rendesishem per numrin e llojeve faunistike qe vizitojne habitatet e zones ne kerkim te ushqimit, apo e perdorin ate dhe si rruge kalimi. Ato jane kryesisht te kultivuara me jonxhe (*Medicago sativa*), por kultura te tjera perfshijne dhe llojet si qepa, domate, patellxhan, patate, bamje, kastraveci, etj. Hortikultura ne zonen e studimit eshte e perfaqesuar nga hardhite, fiku, hurma, mani, etj. Nderkohe, tokat e braktisura dhe kane prirjen te mbulohen nga bimesi oportuniste si manaferra (*Rubus ulmifolius*), megashtra (*Dittrichia viscosa*). Terfili gjethengushte (*Trifolium angustifolium*), grashine dimerake (*Vicia villosa*), lulekuqja (*P. rhoeas*), Ushqereza e zakonshme (*Echium vulgare*), Gjemb gomari (*Cirsium vulgare*), etj. Pavaresisht se keto habitate kane shkalle te larte te ndikimit te njeriut dhe paraqiten me vlere te ulet botanike, ato ende perfaqesojne vlera estetike si pejsazh bujqesor dhe rural.



**Figura 11 Foto te bimesise perfaqesuese te zones ne vleresim dhe habitateve kufizuese.**

Gjithashtu, ujembledhesit ne afersi te zones, jane habitate me rendesi ekologjike ne nivel lokal, pasi ata strehojne lloje te flores dhe faunes se eger, apo perdoren si habitate kritike per riprodhim e ushqim per disa lloje te faunes se eger ujore, perfshire amfibet, reptilet, shpendet dhe gjitaret. Keta ujembledhesa duket se perdoren si burim uji dhe ushqimi per afro 10 lloje lakuriqesh nate (gjate nates) dhe nje numer shpendesh ujore dhe insektngrenes, gjate dites. Keto habitate jane me rendesi edhe per llojin globalisht te rrezikuar te bretkoces shqiptare (*Pelophylax shpipericus),* e cila konsiderohet me status globalisht te rrezikuar per shkak te arealit te saj te kufizuar dhe njeherazi ritmit te larte te humbjes se habitateve te saj natyrore ne te kaluaren per shkak te tharjes se kenetave pergjate ultesires se Adriatikut. Po keshtu, ato jane vende ushqimi dhe riprodhimi per kredharakun e vogel (*Tachybaptus ruficollis)* dhe pulen e ujit (*Gallinula chloropus*).

- **Gjelberimi dhe rehabilitimi i mjedisit ne Zonen e Trajtimit te Mbetjeve Tirane**

Ne Zonen e Trajtimit te Mbetjeve te Tiranes jane mbjelle shumellojshmeri pemesh, dhe eshte gjelberuar me bimen e jonxhes Leticia. Me poshte jane te paraqitura zonat e mbjella dhe llojet e pemeve.

**Zona 1.**

Siperfaqja e kesaj zone eshte ~ 48000 m² dhe ndodhet ne pjesen hyrese / perimetrale te Landfill-it ekzistues deri ne brendesi afer impiantit te trajtimit te ujerave. Ne kete zone jane mbjelle fidane te llojit Ligustra, Lejland, Akacie, Ilqe, Dafina, Oleander. Gjithashtu siperfaqja eshte mbjelle edhe me fare jonxhe Leticia e cila ofron gjelberim ne pjesen me te madhe te vitit.

**Zona 2.**
Siperfaqja e kesaj zone eshte ~ 26000 m² dhe ndodhet ne pjesen perimetrale te Landfill-it ekzistues deri te zyrat operative te menaxhimit te mbetjeve. Ne kete zone jane mbjelle fidane dhe peme te llojit Lejland, Portokalle, Limona, Akacie. Gjithashtu kjo siperfaqe eshte gjelberuar me fare jonxhe te llojit Leticia.

**Zona 3.**
Siperfaqja e kesaj zone eshte ~ 2000 m² dhe ndodhet ne pjesen e pasme te zyrave operative te menaxhimit te mbetjeve. Ne kete zone jane mbjelle fidane te llojit Akacie, Ligusta, gjithashtu eshte gjelberuar me fare jonxhe te llojit Leticia.

**Zona 4.**
Siperfaqja e kesaj zone eshte ~ 14000 m² dhe ndodhet perballe Landfill-it ekzistues, perbri rruges qe shkon per te zyrat operative te menaxhimit te mbetjeve. Eshte gjelberuar me fare jonxhe te llojit Leticia dhe fidane akacie.

**Zona 5.**
Siperfaqja e kesaj zone eshte ~ 33000 m² dhe ndodhet ne pjesen e poshtme te Landfill-it ekzistues, ne afersi te Liqenit te vjeter. Ketu jane mbjelle fidane plepi 2-3 vjecar dhe eshte gjelberuar me fare jonxhe te llojit Leticia.

**Zona 6.**
Siperfaqja e kesaj zone eshte ~ 20000 m² dhe ndodhet ne afersi te Liqenit te vogel, ne pjesen ballore Landfill-eve te reja. Ketu jane mbjelle ullinj, fidane te ndryshem frutor dhe vreshtari rrushi.

**Zona 7.**
Siperfaqja e kesaj zone qe eshte skarpate eshte ~ 1500 m² dhe ndodhet ne afersi te rotondos te Landfill-et e reja. Kjo zone eshte gjelberuar me fare jonxhe te llojit Leticia.

**Zona 8.**
Siperfaqja e kesaj zone eshte ~ 4500 m² dhe ndodhet perbri rruges te Landfill-i mbetjeve urbane. Eshte gjelberuar me fare jonxhe te llojit Leticia dhe portokalle, limona.

**Zona 9.**
Siperfaqja e kesaj zone eshte ~ 3000 m² dhe ndodhet perbri rruges te Landfill-I mbetjeve urbane. Eshte gjelberuar me fare jonxhe te llojit Leticia dhe portokalle, limona.

**Zona 10.**
Siperfaqja e kesaj zone eshte ~ 4000 m², dhe jane skparpatat nga ana e jashtme e Landfill-ve te reja ne rrugen qe shkon per te shtylla elektrike e tensionit te larte. Eshte gjelberuar me fare jonxhe te llojit Leticia.

**Zona 11.**
Siperfaqja e kesaj zone eshte ~ 1000 m² dhe eshte skarpata e pjeses ku do te jete impianti i trajtimit te mbetjeve, ne anen e jashtme perbri restorantit. Eshte gjelberuar me fare jonxhe te llojit Leticia dhe lule kacavjerrese jasemin.

**Zona 12.**

Siperfaqja e kesaj zone eshte ~ 6500 m² dhe ndodhet perbri rruges qe shkon per te Landfill-et e reja dhe Liqenit te vjeter. Eshte gjelberuar me fare jonxhe te llojit Leticia dhe fidane te ndryshem frutor.

**Zona 13**

Siperfaqja e kesaj zone eshte ~ 1000 m² dhe ndodhet te Liqeni i ri, te gazebo. Eshte gjelberuar me tapet bari natyral, fare jonxhe Leticia dhe jane mbjelle peme Ilqe, Shelgje vajtues, Rrape.

**Zona 14.**

Siperfaqja e kesaj zone eshte ~ 1000 m² dhe ndodhet perbri Liqenit te ri, ne anen e jashtme nga rruga e fshatit. Eshte gjelberuar me fare jonxhe te llojit Leticia dhe fidane akacie, shelgje.

**Zona 15.**

Siperfaqja e kesaj zone eshte ~ 12000 m² dhe ndodhet ne afersi te Liqenit te ri, ne pjesen e fundore te siperfaqes te zones se trajtimit te mbetjeve. Eshte gjelberuar me fidane plepi dhe akacie, gjithashtu eshte e gjelberuar me fare jonxhe te llojit Leticia.

**Zona 16.**

Siperfaqja e kesaj zone eshte ~ 4000 m² dhe ndodhet ne afersi te zones 15. Eshte gjelberuar me fare jonxhe te llojit Leticia dhe fidane plepi, akacie.

**Zona 17.**

Siperfaqja e kesaj zone eshte ~ 8000 m² dhe ndodhet me siper siperfaqes 16, perbri rruges qe shkon per ne fshat. Eshte gjelberuar me fare jonxhe te llojit Leticia.

**Zona 18.**

Siperfaqja e kesaj zone eshte ~ 1500 m² dhe ndodhet ne pjesen hyrese te Landfill-it ekzistues, eshte gjelberuar me fare jonxhe Leticia dhe fidane akacie.

**Zona 19.**

Siperfaqja e kesaj zone eshte ~ 700 m² dhe eshte skarpata e rruges qe ngjitesh per te kapanoni i selektimit te mbetjeve. Eshte gjelberuar me fare jonxhe Leticia.

**Zona 20.**

Siperfaqja e kesaj zone eshte ~ 14000 m² dhe ndodhet ne pjesen hyrese te Zones se Trajtimit te Mbetjeve. Eshte gjeleberuar me fare jonxhe Leticia dhe plepa te medhenj, akacie, mimoza. Gjithashtu ne pjesen hyrese perbri rruges dhe poshte emrit te shoqerise, jane mbjelle lule te ndryshme dekorative si trendafila etj. Perbri rruges hyrese te ZTMT gjithashtu jane mbjelle lule dekorative dhe lejlander.

Gjithashtu, ne zonen perrreth zyrave te shoqerise Integrated Energy BV SPV jane mbjelle mimoza, akacie dhe eshte gjelberuar me jonxhe Leticia. Ne rotondon e rruges qe shkon per te lendfillet e reja eshte mbjelle nje peme ulliri shumevjecar.

Ne zonen e Trajtimit te Mbetjeve Tirane, deri ne kete faze punimesh eshte gjelberuar me jonxhe Leticia, siperfaqja ~ 205 000 m² toke ose 21 Ha. Jane mbjelle nje numer i konsiderueshem pemesh, qe perllogariten ~ 55 000 fidane te llojeve te ndryshem, si me poshte:

1. Plepa te bute jane mbjelle ~ 32 000 fidane te madhesive te ndryshme, 1-2 vjecare dhe 5-6 vjecare (ne kohen e mbjelljes).

2. Akacie jane mbjelle ~ 15000 m² fidane te madhesive te ndryshme, 1 vjecare dhe 2 vjecare (ne kohen e mbjelljes).
3. Ullinj jane mbjelle ~ 150 fidane 1 vjecare (ne kohen e mbjelljes).
4. Fidane frutore te ndryshem, si portokalle, limona, kumbulla etj. jane mbjelle ~ 600 cope.
5. Hardhi rrushi, jane mbjelle ~ 400 cope.
6. Peme apo fidane te tjera te ndryshme si ilqe, ligustra, dafina, lejland, arizona, oleander, rrepe, shelgje, mimoza etj. jane mbjelle ~ 7000 cope.

Pershkrim:

1. **Jonxha** eshte bime shumevjecare dhe i perket familjes se bishtajoreve e cila mund te rritet deri ne 100 cm. Ka nje sistem te fuqishem rrenjor i cili shkon deri ne 20 m thellesi, qe permireson struktures dhe pershkrueshmerine e ajrit te tokes, gjithashtu dhe prania e aminoacideve dhe elemeteve kimike te vlefshem per shendetin e njeriut. E thene ne fjale popullore jonxha mund te konsiderohet edhe si "sheruesi i madh" pasi permban elemente kimike qe trupi njeriut nuk mund ti prodhoje.
2. **Plepi,** eshte peme qe ben pjese ne grupin e bimeve gjetherenese te familjes Salicaceae dhe eshte lloj druri i fuqishem i tip shkurre. Eshte ideal per thyerjen e ererave dhe per pamje te bukur te zones ku mbillen dhe mund te arrijne deri ne 35 m lartesi. Dru i larte i familjes se shelgjeve, me trung te drejte e me dege te holla te shtrira perpjete, me gjethe ne trajte zemre, qe rritet shpejt ne vende me lageshtire dhe qe ka lende te pershtatshme per ndertim, per orendi shtepiake, per prodhimin e letres etj.
3. **Akacie,** eshte nje gjini e pemeve dhe shkurreve qe i perket familjes Fabaceae, te cilat mund te arrijne deri ne 25 m lartesi dhe kjo eshte bime qe rregullon nivelin e azotit ne natyre. Perdoren per te zbukuar kopshtet dhe per pyllezim, gjithashtu lulja e kesaj bime eshte aromatizuese. Sistemi rrenjor i akacies eshte shume i dobishem per siperfaqet e pjerreta pasi lidh token. Akacia eshte dru bishtajor i vendeve te ngrohta, me levore te plasaritur, me gjemba, me gjethe vezake te renditura ne te dy anet e nje bishti te gjate dhe qe ben lule zakonisht te bardha, te grumbulluara ne vile e me ere te mire.
4. **Ilqet,** jane lloj dushku i vendeve mesdhetare, me trung te shkurter e te trashe dhe me shume dege, me gjethe dhembe-dhembe, gjithmone te gjelbra e te shkelqyeshme nga siper, qe ben lende te vogla gjatoshe e me thumb ne maje.
5. **Ulliri,** eshte bime subtropike qe i perket familjes Oleaceae. Fruti dhe vaji i ullirit perdoret per ushqim, perdorim mjekesor, sapun etj. Gjethja e ullirit me ane te heterozideve dhe acidit glikolik veprojne drejteperdrejte kunder hipertensionit ne fazen fillestare.
6. **Ligustra** apo e njohur ndryshe edhe si voshter kineze apo voshter e ndritshme eshte nje lloj bime e gjinise *Ligustrum*, ne familjen e ullirit. Prejardhjen e ka nga Kina dhe rritet e kultivuar ne shume vende mesdhetare dhe ne jugun e SHBA-se. Rritet deri ne 10 m dhe ka gjethe me ngjyre te gjelber te erret, me shkelqim. Lulet i ka ne tufa e te bardha, me arome te forte, dhe prodhon shume fruta te vegjel te vendosur

ne tufa. Ligustra ne pergjithesi mbillet ne vende me temperature jo te uleta, pasi eshte peme qe nuk duron ngricat.

7. **Dafina,** eshte dru ose shkurre qe rritet ne vendet mesdhetare, me gjethe gjithmone te gjelbra e me ere te kendshme, qe ben kokrra te vogla me ngjyre te erret.
8. **Lejlander,** eshte nje peme me gjelberim te perhershem dhe rritet ne nje lartesi prej 15 metrash ne 16 vite. Kjo peme rritet shume shpejt dhe njihet per ngjyren e forte jeshile dhe madhesine. Per shkak te formes qe ka me deget nga lart ne drejtim te qiellit, njihet si pema simbol e pavdekesise, shpreses dhe madheshtise.
9. **Arizona,**
10. **Rrap,** eshte dru i larte me trung te trashe, me dege te gjera, me gjethe te medha ne trajte pellembe, qe ben lende te vogla me gjemba te imet persiper.
11. **Shelgu,** eshte dru ose shkurre me dege te holla e te lakueshme dhe me gjethe gjatoshe, te ngushta a vezake, qe rritet zakonisht ne vende me lageshti.
12. **Portokall,** eshte peme e familjes se agrumeve, me gjethe te zgjatura, te lemuara e gjithnje te gjelbra, me lule te bardha e te murrme, qe rritet ne vende me klime te ngrohte dhe ben kokrra te rrumbullaketa, me lekure te trashe e te verdhe ne te kuqe kur piqen. Kokrra e kesaj peme, ka tul te ndare ne disa pjese, me shume leng, te embel dhe me ere te mire.
13. **Limon,** eshte nje hibrid i bimeve te egra te kultivuara dhe i perket familjes Rutacease. Fryti zakonisht perdoret per lengun e tij, gjithashtu tuli dhe levorja perdoren ne kuzhine.
14. **Rrush,** eshte nje frute i nje peme te familjes Vitaceae. Rrushi mund te hahet ose te perdoret per te bere vere, recel, leng rrushi, pelte, ekstrakt te fares se rrushit, stafidhe, uthull dhe vaj i fares se rrushit.
15. **Mimoza,** eshte dru i viseve te ngrohta, me trungun te mbuluar me levore te lemuar, me gjethe te holla e perhere te blerta, i cili cel ne fund te dimrit lule te imeta me ngjyre te verdhe e me ere te mire.

Ne vijim paraqiten foto nga zonat e rehabilituara dhe te gjelberuara te Z.T.M.T.:











**Figura 12 Gjelberimi ne Zonen e Trajtimit te Mbetjeve Tirane**

Me poshte paraqitet harta e gjelberimit te Zones se Trajtimit te Mbetjeve Tirane.




**Figura 13 Siperfaqet e mbjella ne Zonen e Trajtimit te Mbetjeve Tirane**

### 1.2. Fauna

***Gjitaret*** - Referuar te dhenave studimore te ngjashme per zonat ne afersit te publikuara me pare, si dhe kerkeses se llojit per habitat, vleresohet se ne zonen e studimit te jene te zakonshem llojet si nuselalja, qelbesi, urithi, brejtesit (*Mus sp., Rattus sp., Apodemus sp.),* hundegjatin e kopshteve, si dhe nje sere lakuriqesh nate (*Pipistrellus sp., Phinolophus sp., Miniopterus schreibersi, Myotis blyt*hi, etj.) qe jane te lidhur kryesisht me vendbanimet pergjate lumit. Pjesa me e madhe e llojeve preferojne habitatin e tokave me bar, tokave bujqesore, shkurretave dhe pyjeve bregore. Nderkohe, nje pjese e vogel frekuentojne dhe mjediset ujore perreth rezervuareve ujor ne afersi te zones ne studim si dhe habitate te tjera kufizues.

***Shpendet -*** Habitatet ne studim mbeshtesin nje numer te vogel shpendesh krahasuar me numrin total qe gjenden ne Shqiperi. Pjesa me e madhe e llojeve preferojne habitatet e terreneve te hapura dhe tokave me bar, si psh. bishtbardha e gurit (*O. oenanthe*), dervishi (*G. cristata*), mizakapesi i perhimte (*M. striata*), laraskat (*Corvus sp*.), etj.; Lloje te tjera, si kredharaku i vogel (*T. ruficollis*), bishtundesat (*M. alba, M. flava)*, bilbilthat (*Luscinia megarhynchos, Alcedo atthis*), qyrylyku i vogel (*Actitis hypoleucos*), pulebardha (*Larus ridibundus*), etj., jane te lidhur ngushtesisht me formacionet e kallamishteve dhe bimesine shoqeruese te mjediseve ujore (perrenj /rezervuare uji). Po keshtu prane vendbanimeve perreth, mund te vrojtohen llojet si: turtulli, kumuria, sorra, laraka, drenja, dervishi, dallendyshet, dejka, etj.

***Reptilet*** - Diversiteti i reptileve ne zonen e studimit vleresohet i ulet ne lloje. Me perhapje me te zakonshme jane biroja (*M. monspesulanum*), hardhuca e murit (*Podarcis muralis*), hardhuca e barit (*Podarcis taurica)*, zhapiu i gjelber (*Lacerta viridis*), zhapiu me tre vija (*Lacetrta trilineata*), bollat (*Elaphe sp.*), shigjetat (*Coluber Sp.),* etj.

***Amfibet*** - Referuar kerkeses se llojit per habitat, si dhe studimeve te ngjashme te zonave ne afersi, ne afersi te zones ne vleresim kane perhapje te zakonshme: bretkosa e zakonshme e gjelber (*P. kurtmuelleri*), bretkosa barkverdhe (*B. variegata*), si dhe thithlopat (*B. bufo* dhe *B. viridis*). Keto lloje kane valence ekologjike te gjere duke u pershtatur lehte me tipet e habitateve, vecanerisht me mjediset e kanaleve dhe pellgjeve ujore ne afersi te zones ne studim.

## 1.3. Zonat e Mbrojtura dhe Monumentet e Natyres

Zonat e mbrojtura bashke me monumentet e natyres perfaqesojne nje rrjet siperfaqesh qe mbrohen ne shkalle te caktuar, sipas percaktimeve kategorike te tyre, per shkak te vlerave natyrore kombetare, por edhe rajonale e globale.

***Zona e propozuar per zhvillimin e projektit nuk perfshihet brenda asnje zone te mbrojtur dhe nuk nderpret asnje te tille apo monumente natyre.***




**Figura 14 Largesia nga Zonat e Mbrojtura Mjedisore (burimi: ASIG)**

Sic vihet re nga harta e mesiperme, gjithashtu ashtu sikurse u shpjegua ne paragrafet e mesiperm, ne siperfaqen ku do te zhvillohet aktiviteti nuk ka zona te mbrojtura mjedisore. Zona e Mbrojtur Natyrore me e afert, Mali i Dajtit, ndodhet ne distance rreth 14 km nga zona ne studim.

## 1.4. Pershkrimi i mjedisit

### 1.4.1. Gjeologjia

Nga pikepamja gjeologjike, zona ne studim shtrihet mbi dy njesi qe jane sinklinali i Tiranes dhe antiklinali i Baldushkut.

*Sinklinali i Tiranes*, mbi te cilin eshtei vendosur qyteti i Tiranes shtrihet ne veri te kodrave te Sharres. Ai shtrihet ne sektorin lindor te Ultesires Pranadriatike dhe perfshihet ne nje strukture regjionale thyerjesh inverse dhe mbihipjesh postpliocenike, karakteristike per tektoniken e Albanideve te Jashtme. Sinklinali i Tiranes ka nje forme te zgjatur me shtrirje verilindje-jugperendim dhe ndertohet kryesisht nga depozitime tee Miocenit te siperm (N31). Keto lloj depozitimesh gjenden ne kodrat perreth qytetit te Tiranes dhe perbejne formacionin baze te depozitimeve te reja te Kuaternarit mbi te cilat eshte ndertuar qyteti i Tiranes. Perfaqesohen nga argjilite, ranore dhe ne disa raste edhe shtresa karbonatikesh.

*Ranoret* jane te perbere nga grimca te vogla dhe te medha, me ngjyre te verdhe - gri. Gjenden ne shtresa 0.3m deri ne 15-20m trashesi.
*Alevrolitet* perfaqesojne pasazhe graduale nga ranoret neargjilite dhe gershetimin e tyre. Ata janena ngjyre te verdhe - kafe dhe gri - kalter dhe trashesia e tyre varion prej 2.0m ne 4.0m.
*Argjilitet* jane te gjelber me ngjyre gri dhe disa here me ngjyre te zeze. Ata jane shume te forte dhe kompakte. Trashesia ne mes te shtresave shkon nga 0.8m deri ne disa metra.
Trashesia e pergjithshme e depozitimeve te Miocenit te siperm arrin me shume se 200m.Siperfaqja e ketyre depozitimeve eshte e perajruar. Keto depozita dalin ne siperfaqe ne kodrat e Tiranes.
*Depozitimet e kuaternarit* jane pak te zhvilluar ne zonen e Sharres. Si rezultat i erozionit te shpateve keto depozitime perfaqesohen kryesisht nga deluvionet dhe eluvionet qe jane grumbulluar ne rreze te shpateve te pjerret. Ato perfaqesohen nga suargjila te mesme deri te renda dhe argjila.Jane depozitime pak deri ne mesatarisht te konsoliduara. Me karakteristika te mira fizike dhe mekanike, por nuk jane te qendrueshme ne shpatet e lugines. Trashesia e tyre eshte me pak se 2 m dhe jane te perhapur kryesisht pergjate lugines se perroit te Sharres. Gjeresia maksimale e shtratit te perroit eshte 15-20 m ndersa trashesia e shtreses se aluvioneve rreth 2 m.

Ne perendim te sinklinalit te Tiranes zhvillohet antiklinali i Baldushkuti cili shtrihet deri ne zonen kodrinore te fshatit Sharre. Formacionet qe ndertojne antiklinalin e Baldushkut jane ato te Neogjenit dhe Oligocenit dhe perfaqesohen nga argjila, alevrolite dhe ndershtresa te rralla ranoresh dhe konglomeratesh.

Ne zonen e Sharres nuk jane hasur fenomene gjeologjike te cilat mund te paraqesin pasoja negative per qendrueshmerine e bazamenteve shkembore.




**Figura 15 Harta gjeologjike 100K e zones ne studim**

### *Sizmiciteti*

Ne baze te rajonizimit sizmik te Shqiperise zona e studimit tone perfshihet ne zonen sizmike me intensitet 7 balle, sipas shkalles MKS (viti 1964) dhe magnitude 6.5-7 per kushte mesatare trualli.




**Figura 16 Harta e rrezikut gjeologjik Qarku Tirane**




**Figura 17 Harta e rrezikut gjeologjik Qarku Tirane**

### 1.4.2. Gjeomorfologjia

Projekti po zhvillohet ne zonen e Sharres. Zona ndahet me territorin e Tiranes nga nje koder e vogel, qe eshte kodra e Sharres dhe ngrihet ne nje lartesi prej 250-300 m mbi nivelin e detit. Njekohesisht kjo koder sherben edhe si ujendares natyror i pellgjeve ujembledhes te lumit te Tiranes dhe atij te Erzenit. Ne verilindje te saj zgjatet vargu Vaqarr-Sharre-Sauk-Farke.Vete terreni i propozuar per zhvillimin e projektit ka karakter fushoro-kodrinor dhe gjendet ndermjet kuotave 95 dhe 125 m mbi nivelin e detit. Mes permes saj zhvillohet lugina e perroit te Sharres. Ne zone eshte shume i zhvilluar erozioni si pasoje e te cilit shpatet ne te dy anet e lugines jane mjaft te pjerret, me renie 40 deri ne 50º.



**Figura 18 Harte e formave te relievit te zones ne studim**

### 1.4.3. Tokat

Bazuar ne klasifikimin kombetar pedologjik sipas zonalitetit vertikal, tipi me i perhapur i tokave ne zonen ne studim jane Tokat e Hinjta Kafe. Keto toka jane zhvilluar kryesisht ne zonen perendimore te vendit ne lartesite midis 0 – 200 m nga niveli i detit dhe shpesh shtrihen deri ne lartesine 600m mbi nivelin e detit.

Formimi i Tokave te Hinjta Kafe kushtezohet nga klima mesdhetare kodrinore qe karakterizon zonen dhe shkembinjte terrigjene qe e perbejne ate. Karakteristike e pergjithshme e ketyre tokave eshte ngjyra e hinjte kafe, perberja mekanike me e rende ne horizontin B, reaksioni neutral dhe lehtesisht bazik.Keto jane toka minerale, me shkalle te ndryshme te diferencimit te profilit dhe prirje argjilizimi ne shtresen e mesme te tij. Formula e profilit te tokave te hinjta kafe eshte A1-A2-AB-BC-C ose A-AC-C.Ato kane permbajtje mesatare humusi dhe azoti ne horizontin A, te varfera me P, te pasura me K dhe $CaCO_3$, si dhe te saturuara me baza. Keto toka kane pergjithesisht cilesi dhe strukture fizike te mire per shkak te permbajtjes se humusit, $CaCO_3$ dhe bazave ne kompleksin thithes.

Ne pergjithesi zona ne fjale konsiderohet si zone agrikulturure, por kryesisht eshte e mbjelle me foragjere ose e pakultivuar.

### 1.4.4. Klima

Tirana ben pjese ne nenzonen klimatike fushore qendrore perendimore ku mbizoteron klima mesdhetare fushore me dimer te bute dhe teper te laget dhe vere te nxehte e teper te thate.

***Temperatura***

Temperaturat ne zonen ne studim jane relativisht te larta. Temperatura mesatare vjetore luhatet ne intervalin 15 -16ºC. Muaji me i ftohte i vitit eshte janari me temperature mesatare 5°C, por dite te ftohta verehen edhe gjate vjeshtes apo fillimit te pranveres. Muajt me te nxehte te vitit jane korriku dhe gushti me temperature mesatare 24°C. Vlerat skajore te temperatures luhaten ne kufij mjaft te medhenj nga – 8ºC/- 9ºC (minimumi absolut) ne 40ºC/41ºC (maksimumi absolut). Zona dallohet per vlera te larta te diellezimit: shuma vjetore e oreve me ndricim diellor arrin 2600 ore. Mesatarisht ne periudhen dhjetor – mars mund te shfaqen ngricat qe zakonisht zgjatin pak, rrallehere gjate gjithe dites.




**Figura 19 Temperatura e ajrit ne Tirane**

## *Reshjet*

Ne zonen ne studim sasia e reshjeve vjetore eshte rreth 1200mm. Sasia me e madhe e reshjeve te regjistruara eshte 1770mm dhe me e vogla 770mm ne vit. Ne krahasim me vleren mesatare te territorit shqiptar (140mm), kjo zone eshte me e ulet ne sasine e reshjeve atmosferike. Shperndarja e reshjeve gjate vitit ka nje forme “U” qe eshte tipike e nje regjimi mesdhetar te reshjeve. Sasia me e madhe e reshjeve verehet gjate periudhes se ftohte te vitit dhe muajt me te lagesht jane Nentor-Dhjetor (162 dhe 141mm perkatesisht). Muaji me i thate eshte Korriku (38mm).




**Figura 20 Reshjet atmosferike ne Tirane**

### *Era*

Nje tjeter element mjaft i rendesishem i klimes eshte edhe era. Parametrat kryesore te eres qe do te analizohen ne kete paragraf jane drejtimin dhe shpeshtesia sipas drejtimeve te ndryshme si dhe shpejtesia e saj sipas drejtimeve te ndryshme. Shpejtesia mesatare varion nga 2.9 m/s ne 1.5 m/s ndersa ajo maksimale arrin ne raste te vecanta atmosferike (tufane) deri ne 40 m/s. Rastisjen me te madhe e ka drejtimi juglindje me rastisje 15.8% dhe jugperendimi me 15.1%. Shpejtesia e eres ne zonen ne studim eshte ne varesi te periudhes se vitit. Vlerat me te medha te tyre vrojtohen ne stinen e dimrit kur veprimtaria ciklonare eshte e theksuar. Sic shihet nga trendafili i eres se qytetit te Tiranes gjate stines se veres dominojne ererat me drejtim nga veriperendimi ndersa gjate dimrit ato nga juglindja.




**Figura 21 Trendafili i ererave dhe grafiku i shpejtesise se eres ne Tirane**

# 2. INFORMACION PER PRANINE E BURIMEVE UJORE, NE SIPERFAQEN E KERKUAR NGA PROJEKTI DHE NE AFERSI TE TIJ ZBATOHET PROJEKTI

## 2.1. Ujerat siperfaqesore

Trupat ujore siperfaqesore kryesore te zones ne studim jane perroi i Sharres dhe lumi i Erzenit.

Perroi i Sharres, i cili pershkon pothuaj mespermes zonen ne studim, rrjedh nga pjesa kodrinore e fshatit Sharre, ne lartesine rreth 300 m mbi nivelin e detit dhe derdhet ne Erzen afersisht 250 m larg kufirit jugperendimor te zones se propozuar per zhvillimin e projektit. Siperfaqja e pellgut ujembledhes eshte rreth 0.25 $km^2$. Ne sektorin me te siperm te rrjedhes ka nje rezervuar artificial, i cili eshte shnderruar ne nje pellg per shkak te sasise se madhe te sedimenteve ne te. Siperfaqja e rezervuarit eshte 3500 $m^2$ ndersa thellesia maksimale 2 m. Gjate stines se thate, sasia e ujit qe rrjedh nga rezervuari eshte afersisht 0.01l/sek, ndersa ne periudhen e shirave, ai permbytet nga uji. Regjimi i rrjedhes se perroit te Sharres eshte teresisht ne varesi te regjimit te reshjeve; ne pjesen me te madhe te kohes ai ka rrjedhe te paket, por ne raste shirash te rrembyer, sasia e ujit rritet. Bazuar ne vrojtimet e kryera gjate studimit te fizibilitetit per ndertimin e landfillit ekzistues, eshte vene re se sasia e ujit ne periudhen e lagesht (tetor-nentor) eshte 0.7-1.0 l/sek, ndersa prurja maksimale ne kohe shirash te rrembyer mund te mberrije ne 3.5 m3/s1.

Sasia e madhe e mbetjeve te shperndara, kane shkaktuar bllokime te rrjedhes se perroit ne sektore te vecante duke krijuar pellgje.

Erzeni perfaqeson nje nder lumenjte e rendesishem qe pershkojne pjesen qendrore te vendit.Erzeni, i cili rrjedh rreth 250 m ne jug te zones se projektit, ka gjatesi te pergjithshme 109 km dhe siperfaqe te pellgut ujembledhes 760 km2. Prurja mesatare vjetore eshte 18.1 m/s me nje modul te prurjes prej 24 l/s/km2. Pellgu i lumit Erzen zhvillohet ne zonen malore ne lindje dhe juglindje te Tiranes.Ne zonen e studimit, ne afersi te Sharres, Erzeni meandron ne nje lugine te gjere te eroduar, ndersa shtrati i tij zgjerohet dhe krijon tarraca. Rrjedha vjetore e Erzenit ne afersi te Sharres eshte rreth 12-13 m3/sek. Ujerat e lumit Erzen jane perdorur dhe perdoren kryesisht per vaditje dhe shume pak per uje te pijshem (pas depurifikimit). Pergjate lugines se tij ka shume puse te ceket uji qe perdoren per furnizimin me uje ne zonat rurale.

[1]UNEP, Feasibility studyfor urgent risk reduction measures at Sharra landfill in Albania, April 2002




**Figura 22 Hidrografia e zones ne studim**

Sipas hartave te mesiperme (burimi: ASIG), largesia e trupit ujor siperfaqesor me te afert (brenda Zones se Trajtimit te Mbetjeve Tirane) eshte rreth 30m ne vije ajrore. Largesia e instalimit nga lumi Erzen eshte mbi 700m ne vije ajrore.

Brenda Zones se Trajtimit te Mbetjeve Tirane gjenden 3 basene te ujerave siperfaqesore, analizat e te cilave kryhen ne nje frekuence 3 dhe 6 mujore nga laboratori i akredituar “Qendra e Monitorimit Mjedisor”. Keto analiza jane dorezuar ne Agjencine Kombetare te Mjedisit si pjese e raporteve te vetmonitorimit (bazuar ne Lejen e Mjedisit te Tipit A me te cilen eshte i pajisur dhe operon lendfilli ekzistues i

mbetjeve urbane) dhe raporteve te zbatueshmerise se Vendimeve per VNM Paraprake te objekteve qe jane ende ne faze ndertimi.

Shoqeria "Integrated Energy BV SPV" Sh.p.k. eshte e pajisur me leje per perdorim ujor siperfaqesor per ujitje, te miratuar me ane te Vendimit te Keshillit nr. 7, date 10.12.2021 te Basenit Ujor Erzen. Leja e cituar me siper gjendet ne vijim.

Nr. 25 Prot.
Dt. 18/01/2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KRYEMINISTRIA**
**AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE**

Nr. 108 Prot. Tiranë, më 17.01.2022

**Lënda:** Përcjellje dokumentacioni.

**SUBJEKTIT "INTEGRATED ENERGY BV SPV" SH.P.K**
Adresa: Zona Kadastrale nr.3321, Vaqarr, Tiranë

Në vijim të kërkesës suaj për leje për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për ujitje në rastin kur përdorimi është për >5 ha, >5 l/sek, për projektin e landfillit, inceneratorit dhe prodhimin e energjisë elektrike me të dhënat: Nr.AN140620210005, të datës 14.6.2021, ju njoftojmë se:

Bazuar në ligjin Nr 111/2012 "Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", i ndryshuar, VKM nr. 550, datë 15.7.2020, referuar mbledhjes të mbajtur nga KBU Erzen në datë 10.12.2021 bashkëlidhur po ju dërgojmë Leje Nr. 5/11, datë 17.12.2021 për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për ujitje si dhe Vendimin Nr. 7, datë 10.12.2021.

Gjithashtu, referuar pikës 2, të nenit 71, të ligjit Nr 111/2012 "Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", në të cilën parashikohet se: "*Personi juridik, përgjegjës për ndërtimin,* ***brenda 30 ditëve nga përfundimi i veprës a objektit, duhet të njoftojë organet e administrimit a menaxhimit të burimeve ujore,*** *që kanë lejuar kryerjen e veprimtarisë, që të kryejnë inspektimin përfundimtar në këtë vepër a objekt ujor*", lutemi nga ana juaj realizimin e njoftimit sipas parashikimit të mësipërm.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Gerta Lubonja**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

**DREJTOR, DREJTORIA E MENAXHIMIT TË PERFORMANCËS**

**Herm[illegible]ati**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE
TIRANË
KRYEMINISTRIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I BASENIT UJOR ERZEN**

5/10 KBU
17.12.21

**VENDIM**

Nr.7, datë 10/12/2021

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES "LEJE PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR UJITJE", SHOQËRISË "INTEGRATED ENERGY BV SPV" SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "*Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre*", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Erzen,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e lejes "Për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për ujitje", shoqërisë "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k., me vendndodhje, Bashkia Tiranë,Qarku Tiranë, sipas këtyre koordinatave:

2. Treguesit janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor

- X=479494.54
- Y=4572523.8
- Z=73.6 m.m.n.d

Sipërfaqja e parcelës, që do të ujitet: 18.6 ha
Prurja e ujit të kërkuar: 100 l/s

Vendndodhja e pikës së shkarkimit

- X=480069.6
- Y=4573679.69
- Z=135 m.m.n.d

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

**KRYETARI I KBU ERZEN**

**AFRIM QËNDRO**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I BASENIT UJOR ERZEN**

*Nr. Serial: 000008*

**LEJE**
**PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR**

Nr. 5/1 Prot., datë 17/12/21

Miratuar me:
VENDIM TË KËSHILLIT TË BASENIT UJOR ERZEN
Nr.7, datë 10.12.21

Emri i individit/subjektit: **Integrated Energy BV SPV sh.p.k**

I regjistruar si subjekt me këto të dhëna (NID/ NIPT): **L72031013B**

Baseni Ujor: **Erzen**

Qarku: **Tiranë**

Bashkia/ Njësia administrative: **Tiranë**

Koordinatat e veprimtarisë: **X = 479494.54** **Y = 4572523.8** **Z = 73.6 m.m.n.d**

Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: **Për ujitje**

Prurja mesatare vjetore: **10690 l/s**

Prurja ekologjike: **510 l/s**

Sasia e ujit që jepet për përdorim: **100 l/s**

Vëllimi i rrjedhës së kthyer (nëse ka): -

Koordinatat ku do të shkarkohet rrjedha e kthyer:

**X =** - **Y =** - **Z =** -

Koordinatat e shkarkimit të ujërave të përdorura

**X = 480069.6** **Y = 4573679.69** **Z = 135 m.m.n.d**

Sipërfaqja e tokës, së cilës i shërben përdorimi i ujit (në rastin e ujitjes): **18.6 (ha)**

Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë (nëse ka): **Sipas kushteve të lejes**

Periudha e vlefshmërisë: **5 VJET**

Hyrja në fuqi: **Pas publikimit në regjistrin kombëtar të Licencave dhe Lejeve**

**KRYETARI**
**AFRIM QËNDRO**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I BASENIT UJOR ERZEN

**Kushtet e posaçme të lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor**

1. Të përdorë ujërat në mënyrë racionale, duke shmangur mbetjet dhe duke mos dëmtuar mjedisin;
2. Të përdorë ujërat vetëm për qëllimet, për të cilat i është dhënë leja;
3. Të paguajë të gjitha kostot, taksat, tarifat në lidhje me përdorimin e ujit;
4. Të instalojë ose të lejojë instalimin e pajisjeve për matjen e sasisë së ujit të përdorur, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organet e menaxhimit të burimeve ujore;
5. Të regjistrojë vëllimin ditor të ujit të përdorur, përfshirë dhe rrjedhën e kthyer, në një regjistër të posaçëm dhe të raportojë çdo 3 muaj pranë AMBU-së;
6. Në rastin e shfrytëzimit të burimit ujor për hidroenergji, të instalojë një stacion hidrometrologjik, për matjen e prurjeve ditore, në një distancë jo më shumë se 150 m poshtë çdo vepre marrjeje dhe të dhënat t'i raportojë çdo 3 muaj pranë AMBU-së;
7. Të japë të dhëna dhe informacion për përdorimin e ujit sa herë që i kërkohet nga organet e ngarkuara për menaxhimin e burimeve ujore;
8. Kjo leje nuk mund t'i transferohet një subjekti tjetër, pa miratimin e organeve të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;
9. Të respektojë kushtet e mbrojtjes së mjedisit dhe të rrethojë sipas projektit brezat sanitarë të mbrojtjes;
10. Të mos dëmtojë brigjet dhe shtratin e burimit ujor, gjatë ndërtimit dhe operimit të veprave;
11. Të mos ndryshojë rrjedhën natyrore të burimit ujor, me përjashtim të rasteve kur kjo është e miratuar nga organet e administrimit të burimeve ujore;
12. Të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e kontrolleve nga autoritetet përkatëse të ujit;
13. Të lejojë rrjedhën ekologjike;
14. Të sigurojë marrjen e menjëhershme të masave dhe veprimeve për të minimizuar, ose parandaluar ndonjë ndikim në mjedisin ujor, ose në brigje në rast të një aksidenti, apo incidenti;
15. Të kompensojë dëmin e shkaktuar dhe të rikthejë mjedisin ujor në gjendjen e mëparshme;
16. Të mos cënojë faunën dhe florën ujore e tokësore dhe të marrë masa për mbrojtjen e specieve të rralla;
17. Të sigurojë, nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, kushte për përdorimin e burimit ujor nga subjekte të tjerë për sasinë e papërdorur;
18. Të zbatojë parimet dhe kushtet të tjera të përcaktuara në ligjin për menaxhimin e burimeve ujore për veprimtarinë përkatëse.

### 2.2. Ujerat nentokesore

Zona ne studim shtrihet mbi dy basene hidrogjeologjike komplekse me karakteristika te ndryshme. Kompleksi hidrogjeologjik ne depozitimet koluviale - Keto depozitime te perfaqesuara nga suargjila, surera dhe rera karakterizohen nga pershkueshmeri e dobet dhe trashesi e vogel, per rrjedhoje nuk ekzistojne kushte per krijimin e rezervave ujore nentokesore. Ne keto depozitime ka vetem burime te perkohshme ne dimer apo pranvere, me shume pak prurje. Ne pjesen tjeter te vitit ne to nuk takohen ujera nentokesore.

Kompleksi hidrogjeologjik ne depozitimet neogjenike qe perbehen nga argjilite, alevrolite dhe ranore. Argjilitet jane depozitime me pershkueshmeri te ulet deri ne te papershkueshme, ndersa ranoret jane pak deri ne mestarisht te pershkueshem.

Drejtimi i levizjes eshte nga Lindja drejt Perendimit, per shkak te drejtimit te renies se relievit. Gjithe ujerat e kodres drenojne ne lumin Erzen.

Referuar studimit hidrologjik te kryer nga "Altea & Geostudio 2000" ne Zonen e Trajtimit te Mbetjeve Tirane (2013), rezulton se niveli i ujit nentokesor ne dimer dhe ne vere eshte shume i ndryshem. Ne pjesen me te madhe te zones niveli i ujit nentokesor eshtelarg siperfaqes se tokes (2.50-6.00m), por ka raste kur niveli i ujit eshte afer siperfaqes dhe kjo ndodh ne momentin e reshjeve masive dhe ne kontaktin ndermjet shtresave argjilite dhe ranoreve, ku dalin burime me prurje te vogel dhe sezonale. Nga analizat e kryera rezulton se jane ujera neutrale dhe jo agresive ndaj hekurit dhe betonit. I vetmi burim ujerash nentokesor ne zone jane depozitimet zhavorrore (konglomeratike) te Erzenit. Per shkak te pershkueshmerise se larte ato perfaqesojne nje akuifer te rendesishem, ne te cilin jane shpuar puse uji per furnizimin e fshatit.




**Figura 23 Harta hidrogjeologjike e zones ne studim**

# 3. INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TE MUNDSHME NEGATIVE NE MJEDIS TE PROJEKTIT

## 3.1. Hyrje

Ky kapitull identifikon dhe analizon ndikimet qe mund te shkaktohen nga aktivitetet e propozuara te projektit. Si baze per vleresimin do te perdoren kushtet aktuale natyrore brenda zones se projektit duke perfshire rreziqet dhe ndikimet qe nuk lidhen me projektin, por te identifikuara ne pershkrimin e mjedisit ekzistues te projektit.

Duke u bazuar ne pershkrimin e shkarkimeve, emetimeve, mbetjeve dhe rreziqeve kryesore qe lidhen me projektin, do te identifikojme dhe vleresojme potencialin mjedisor kryesor, ndikimet social-ekonomike dhe trashegimine kulturore per projektin duke marre ne konsiderate:

**Zonat e ndikimit te identifikuara:** te cilat vleresohen per efektet ne elementet mjedisore, socialekonomik, dhe te trashegimise kulturore (mbi njerezit, shendetin e njerezve, faunen dhe floren, token, perdorimin e tokes, asetet materiale, cilesine dhe hidrologjia e ujit, cilesine e ajrit, klimes, peisazhin dhe mjedisin vizual, objektet historike dhe te trashegimise kulturore, dhe nderveprimet ndermjet tyre), qe potencialisht mund te ndikohen nga aktivitetet e projektit.

**Pershkrimi i ndikimeve:** Nje pershkrim i shkurter i ndikimeve te mundshme ose burimeve te ndikimeve qe mund te ndodhin nga projekti mbi bazen e informacionit aktual ne dispozicion:

- Natyra e ndikimeve (d.m.th. jo te drejtperdrejta, dytesore, akumuluese, te shkurtra, mesatare dhe afatgjate, te perhershme dhe te perkohshme, pozitive dhe negative);
- Mundesia e ndikimit;
- Kohezgjatja, shpeshtesia dhe riparimi i ndikimit;
- Zona e influences: Shtrirja e ndikimit (zona gjeografike, madhesia e receptorit/ popullsise/ habitatit/ specieve te ndikuara) te cilat potencialisht mund te ndikohen. Ne lidhje me zonen e influences, termi "Lokal", perdoret per ndikimet qe ndikojne burimet lokale ose nje habitat te vetem, ne nje zone administrative te vetme (lokale) ose nje komunitet te vetem. Per me teper, mund te kete ndikime lokale qe mund te shtrihen pertej, por qe jane ende brenda kontekstit (p.sh. brenda nje distance prej qindra metrave ose kilometrave nga zonat e projektit; Ndikimet "Rajonale" qe ndikojne burimet rajonale mjedisore, social-ekonomike ose burimet e trashegimise kulturore apo qe ndihen ne nje shkalle rajonale, sic edhe percaktohet nga lloji i habitatit, kufijte administrativ ose komuniteti.

**Burimet e Ndikimit gjate operimit/ funksionimit te qelizes shtese te lendfillit te mbetjeve urbane per zgjerimin e kapacitetit te lendfillit ekzistues te mbetjeve urbane**

- Faza e funksionimit (operimit) dhe mirembajtjes: Menaxhimi i mbetjeve.

**Receptore me Potencial per t’u Ndikuar**

- Ajri, Toka, Habitate, Flora Dhe Fauna.
- Kushtet e Vecanta Baze qe jane Ndikime me Influence Potenciale
- Zona me aktivitet te larte njerezore.

**Faktore te Projektit qe kane potencial per ndikime**

Menaxhimi i mbetjeve, menaxhimi i trafikut, gjeresia e zones se punes, koha e punimeve, niveli i ndikimeve fizike (d.m.th. zhurmat, drita, vizuale, dridhje, cilesia e ujit)

## 3.2. Permbledhje e ndikimeve potenciale mjedisore gjate pergatitjes per fazen e operimit dhe gjate fazes se operimit/ funksionimit te qelizes shtese te lendfillit te mbetjeve urbane

**Tabela 2 Permbledhje e ndikimeve potenciale ne mjedis**

| Zona e ndikuar | Ndikimi Potencial/Burimi |
|---|---|
| Ujera siperfaqesore dhe nentokesore | Ndotja e mundshme e ujerave nentokesore dhe siperfaqesore, si rrjedhoje e ngjarjeve te paplanifikuara (aksidentale), rrjedhjeve/ shkarkimeve te pakontrolluara nga automjetet, makinerite, ujerat e ndotur, derdhjet aksidentale te substancave te rrezikshme si per shembull karburant, lende kimike, mbetje, etj.<br>Gjate fazes se operimit, nga mbetjet gjenerohen ujera te ndotura, te cilat ne rast se nuk grumbullohen kane ndikim negativ te larte ne mjedisin dhe komunitetin e zones. Per grumbullimin e ujerave te ndotura do te instalohen tubacione, puse dhe pompa te cilat do t’i transportojne ujerat per te Impianti i Trajtimit te Ujerave te Ndotura (i cili eshte pershkruar hollesisht ne kapitullin 8 te ketij raporti). |
| Toka | Ndotja e tokes mund te ndodhe si rrjedhoje e rrjedhjeve/derdhjeve te mundshme nga automjetet, makinerite, ujerat e ndotura, derdhje aksidentale te substancave te rrezikshme si karburante, lende kimike, mbetje, etj. |

| | |
|---|---|
| | Ndotja e tokes mund te ndikoje ujerat siperfaqesor dhe nentokesor, burimet dhe puset, etj.<br>Toka mund te ndikohet ne rast ndotjeje aksidentale nga ujerat e ndotura qe gjenerojne mbetjet gjate fazes se operimit. Ashtu sikurse u shpjegua me siper, ujerat e ndotura nuk do te kene kontakt me mjedisin prites pasi do te merren masat e nevojshme per grumbullimin dhe trajtimin e tyre. |
| Cilesia e Ajrit | Ndikimet nga emetimet e automjeteve, pajisjet me djegje, difekte apo aksidente te mundshme.<br>Trafiku i automjeteve dhe aktiviteteve te operimit (ngarkimi ose shkarkimi i automjeteve) ne rruge me cakell apo siperfaqe toke te ekspozuara dhe te pashtruara gjate levizjeve te automjeteve te cilat mund te shkaktojne krijimin e pluhurit;<br>Clirimi i emetimeve ne rast aksidentesh (p.sh, zjarret) mund te behet i rrezikshem per mjedisin, punonjesit dhe banoret, si rrjedhoje e substancave te rrezikshme (lende djegese) dhe afersise se objekteve te banimit.<br>Krijimi i pluhurit mund te perkeqesoje cilesine e ajrit brenda Zones se Trajtimit te Mbetjeve te Tiranes ose te shqetesoje banoret perreth.<br>Clirimi i metanit (biogazit) nga mbetjet urbane gjate fazes se operimit (i cili do te grumbullohet me ane te impiantit te kaptimit te biogazit, qe do te instalohet ne momentin qe gjenerohet sasi e mjaftueshme). |
| Zhurma dhe vibrime | Ndikime nga emetimi i zhurmave gjate operimit normal te lendfillit (d.m.th. automjetet, pajisjet mekanike, etj). Ngjarje jo rutine/te paplanifikuara si per shembull ngjarje emergjence.<br>Efektet e zhurmes mund te ndikojne ne popullsine lokale rezidenciale (dhe receptore te ndjeshem), punonjesit, fauna, etj. |
| Mbetjet | Ne fazen aktuale te projektit, mbetjet inerte qe jane gjeneruar gjate germimit jane depozituar brenda Zones se Trajtimit te Mbetjeve Tirane<br>Gjate shtrimit te HDPE dhe gjeomembranave jane krijuar vetem mbetje te ambalazheve, te cilat jane diferencuar sipas tipologjive ne kapanonin e selektimit te mbetjeve, do te presohen dhe do te terhiqen nga operatore te licencuar.<br>Gjate fazes se operimit te qelizes shtese per zgjerimin e kapacitetit te lendfillit te mbetjeve urbane mbetjet qe do te gjenerohen jane ujerat e ndotura te cilat do te grumbullohen me |

| | |
|---|---|
| | ane te pompave ne vaska dhe me ane te mjeteve te posacme do te transportohen nga shoqeria Gant Construction shpk ne impiantin e trajtimit te ujerave te shoqerise Brema Ambiente shpk sipas Aktmarreveshjes Nr. 940 Prot, Dt. 09.10.2024 me objekt: “Per transportimin dhe trajtimin/asgjesimin e mbetjeve te gjeneruara me kod 19 07 02(rrjedhje nga landfill-et qe permbajne substanca te rrezikshme)”, ku do te kalojne procesin e asgjesimit. Kjo do te kyhet deri ne perfundimin e ndertimit te Impiantit te trajtimit te ujerave te ndotura ne Z.T.M.T. Gjithashtu edhe mbetjet e riciklueshme te cilat do te diferencohen te kapanoni i selektimit te mbetjeve dhe do te terhiqen nga agjente tregtare dhe operatore te licencuar. |
| Shendeti dhe siguria ne pune dhe e komunitetit | Ndikimet ne shendet dhe ne siguri nga emetimet e rrezikshme, demtimeve nga reniet dhe makinerite dhe aksidente te tjera te ngjashme (p.sh. ne rast zjarri). |
| Popullsia lokale | Cdo shqetesim mbi trafikun lokal (levizja e kamioneve mund te bezdisin banoret pergjate rruges se aksesit), krijimi i pluhurave dhe ndotja e burimeve te ajrit dhe ujit nga cdo emetim ose shkarkim aksidental, etj.<br>Ndikuesi kryesor do te jete trafiku i gjeneruar nga levizja e mjeteve te renda dhe kamioneve/automjeteve si gjate procesit te ndertimit dhe gjate funksionimit te projektit. Megjithate mund te thuhet se efektet ne popullsi duke marre parasysh vete territori e zones ne te dy rastet do te jete pothuajse zero pasi distanca e objektit nga zonat e populluara eshte e konsiderueshme.<br>Per me teper, aktivitetet e menaxhimit te mbetjeve urbane ofrojne mundesi punesimi per banoret lokale. Perfitime ekonomike per familjet dhe per ekonomine lokale si rezultat i drejtperdrejt ose jo te drejtperdrejt i projektit. |

### 3.3. Ndikimet ne cilesine e ajrit

Pritet te kete ndikime te lokalizuara dhe te perkohshme ne cilesine e ajrit ne zone si rrjedhoje e emetimeve te gazeve nga pajisjet dhe automjetet e punes. Punetoria eshte ajo qe do te jete me shume e ekspozuar ndaj efekteve te mundshme gjate zhvillimit te proceseve te punes.

Emetimet e gazeve vijne kryesisht nga automjetet dhe pajisjet e perfshira ne transportin e materialeve, personelit, nen-kontraktoreve dhe furnizuesve.

Ndotesit e krijuar nga keto burime te emetimit perfshijne lendet pezull (PM10 dhe PM2.5), Monoksidin e Karbonit (CO), Oksidet e azotit ($NO_X$) dhe Dioksidin e sulfurit ($SO_2$). Emetime te vogla gazesh do te leshohen nga automjetet e levizshme te cilat jane te perfshira ne aktivitet e pergatitjes dhe ndertimit, dhe emetimet e tyre zakonisht nuk arrijne ne distanca me te medha se 100 m nga zona e emetimit. Keshtu qe, ne mungese te receptoreve qe mund te ndodhen ne afersi, ky ndikim eshte i paperfillshem. Gjithashtu, kohezgjatja e transportit te mbetjeve eshte teper e shkurter dhe rrjedhimisht edhe ndikimi nga gazet e emetuara eshte i pakonsiderueshem.

Gjate fazes se operimit te qelizes shtese per zgjerimin e kapacitetit te lendfillit te mbetjeve urbane te pajisur me Leje Mjedisi te tipit A me PN-0762-08-2021, do te kete dhe clirim te metanit (biogazit) nga mbetjet urbane (i cili do te grumbullohet me ane te impiantit te kaptimit te biogazit, qe do te instalohet ne momentin qe gjenerohet sasi e mjaftueshme).

### 3.4. Ndikimet ne toke

Cilesia e tokes dhe karakteristikat e saj gjeo-fizike nuk do te ndikohen nga operimi i ketij aktiviteti, per arsye se nuk gjenerohen mbetje te rrezikshme dhe nuk do te realizohen punime te vazhdueshme ndertimore. Gjithashtu, ashtu sikurse u shpjegua me siper, ne qelizen shtese do te realizohet paketa e papershkueshmerise e cila eshte me 4 shtresa (argjile me trashesi 1 m bazament dhe 50 cm ne pjesen e skarpatave, gjeobetonit, HDPE-2.5mm dhe shtresa e gjeotekstilit per mbrojtjen e 3 shtresave nga demtimet mekanike), per te shmangur riskun e ndotjes se tokes. Ky projekt synon vetem depozitimin e mbetjeve urbane te gjeneruara nga Qarku Tirane.

### 3.5. Ndikimet ne burimet ujore (siperfaqesore dhe nentokesore)

Gjate fazes se operimit, instalimi nuk do te ndikoje ne cilesine e ujerave siperfaqesore dhe nentokesore, pasi lendfilli do te jete i pajisur me paketen e papershkueshmerise (gjeotekstil, gjeomembrane, gjeokompozit) dhe ujerat e ndotura (leksiviatet, shllami) do te grumbullohen ne vaska me ane sistemit te pompave te instaluara dhe me mjeteve te posacme do te transportohen nga shoqeria Gant Construction shpk ne impiantin e trajtimit te ujerave te shoqerise Brema Ambiente shpk sipas Aktmarreveshjes Nr. 940 Prot, Dt. 09.10.2024 me objekt: “Per transportimin dhe trajtimin/asgjesimin e mbetjeve te gjeneruara me kod 19 07 02(rrjedhje nga landfill-et qe permbajne substanca te rrezikshme)”, ku do te kalojne procesin e asgjesimit. Kjo do te kyhet deri ne perfundimin e ndertimit te Impiantit te trajtimit te ujerave te ndotura ne Z.T.M.T .Per kete arsye depozitimi i mbetjeve urbane ne lendfill si projekt nuk ndikon ne pergjithesi ne cilesine e ujerave. Nuk gjenerohen mbetje toksike gjate operimit dhe ujerat urbane nuk do te shkarkohen ne mjedis.

### 3.6. Ndikimet ne biodiversitet

Duke marre ne konsiderate gjendjen ekzistuese te biodiversitetit ne zonen e projektit dhe zonen perreth, ndikimet gjate fazes se operimit dhe fazes se operimit te qelizes shtese te lendfillit te mbetjeve urbane per zgjerimin e kapacitetit te lendfillit ekzistues te mbetjeve urbane, te pajisur me Leje Mjedisi te tipit A (PN-0762-08-2021), do jene minimale ose te paperfillshme. Vendndodhja e projektit eshte ne nje zone e cila eshte zone e zhveshur dhe ne fazen aktuale te projektit nuk parashikohet pastrimi i territorit nga bimesia apo shtresa e vegjetacionit (pasi germimet jane perfunduar). Per shkak te karakteristikave fizike, siperfaqja nuk ofron habitat dhe strehe per faunen dhe floren tipike te zones.

### 3.7. Ndikimet nga gjenerimi i zhurmave

Emetimet e perkohshme te zhurmave nga levizja e automjeteve do te jene burimet kryesore te ndikimit, i cili do te ndikoje kryesisht zonen afer siperfaqes se zhvillimit te punimeve. Vlen te theksohet se zona e studimit nuk eshte shume e populluar dhe dendesia e popullsise eshte 51-200banore/km$^2$ (burimi: ASIG).



**Figura 24 Dendesia e popullsise ne zonen e projektit**

Gjate fazes se operimit, pritet te kete gjenerime me te uleta te zhurmave, te cilat mund te vijne si rezultat i perdorimit te makinerive per depozitimin dhe transportimin e mbetjeve dhe te kamioneve ne zonen e projektit.

Duke iu referear Limiteve te lejuara te zhurmave (Udhezim Nr. 8 date 27.11.2007), vlera e lejuar per per trafikun eshte is LAeq = 70 dB(A) per 24 ore dhe vlera maksimum LAmax fast =110 dB(A).

### 3.8. Ndikimet mbi popullsine lokale

Cilesia e jetes ne komunitetin lokal perreth nuk ka te ngjare qe te ndikohet nga aktivitetet qe kane lidhje me projektin. Nje element pozitiv eshte qe ndertimi i Zones se Trajtimit te Mbetjeve te Tiranes ne teresi dhe qelizes shtese te lendfillit te mbetjeve urbane per zgjerimin e kapacitetit te lendfillit ekzistues te mbetjeve urbane te pajisur me Leje Mjedisi te tipit A me PN-0762-08-2021, do te ndikoje pozitivisht per komunitetin e zones dhe per banoret e Qarkut te Tiranes, pasi do te ofroje nje menaxhim efikas te mbetjeve urbane, konform standardeve evropiane dhe teknikave me te mira te disponueshme.

# 4. PERSHKRIM PER SHKARKIMET E MUNDSHME NE MJEDIS

### 4.1. Ujerat e ndotura

Gjate fazes se operimit do te gjenerohen ujera te ndotura, te cilat do te grumbullohen me ane te sistemit te tubacioneve, pompave dhe puseve e do te percillen per tek vaskat e impiantit te trajtimit te ujerave te ndotura, i cili eshte pershkruar ne menyre te detajuar ne kapitullin 8 te ketij raporti VNM.

Ujerat e ndotura gjenerohen si pasoje e lageshtires qe permbajne vete mbetjet, si dhe nga ujerat e shirave (te cilat perbejne pjesen me te madhe te volumit te ujerave qe do te gjenerohen). Theksojme se sistemi i tubacioneve, pompave e puseve te grumbullimit te ujerave te ndotura eshte vendosur per qelizen ekzistuese te lendfillit te mbetjeve urbane (Pika 13, pajisur me Leje Mjedisi Tip A me PN-0762-08-2021) qe perpara fillimit te fazes se operimit te saj dhe tubacionet e nevojshme per lidhjen e qelizes shtese te lendfillit te mbetjeve urbane (per te cilen po kryhet ky aplikim) do te shtohen ne rrjetin ekzistues.

Aktualisht monitorimi i ujerave siperfaqesore kryhet cdo 3 muaj per lendfillin e mbetjeve urbane (pika 13) sipas percaktimeve te lejes se mjedisit te tipit A me PN-0762-08-2021 me te cilen ky lendfill eshte i pajisur. Ne vijim, leja e mjedisit do te rishikohet per te pasqyruar shtimin e kapacitetit te lendfillit te mbetjeve urbane (pika 13), ku do te shtohen dhe pikat e monitorimit te ujerave siperfaqesore per qelizen shtese te lendfillit te mbetjeve urbane (pika 13).

### 4.2. Gaze dhe pluhur

Gjate fazes se operimit, si dhe gjate fazes se rehabilitimit te qelizes shtese te lendfillit te mbetjeve urbane (pika 13) do te gjenerohet metan nga procesi i dekompozimit te mbetjeve. Per kete arsye do te realizohet impianti i kaptimit te biogazit, i cili eshte shpjeguar ne kapitullin 8 te ketij raporti.

Theksojme se impianti i kaptimit te biogazit do te konsiderohet i perfunduar pasi te dyja qelizat e lendfillit te mbetjeve urbane (pika 13 e pajisur me lejen e mjedisit te tipit A me PN-0762-08-2021 dhe qeliza shtese per te cilen po kryhet ky aplikim) te jene kapsuluar. Funksionimi dhe kapsulimi i te dyja qelizave eshte i lidhur ngushtesisht, pasi ne te dyja qelizat e lendfillit tipologjia e mbetjeve qe pranohen eshte e njejte, procesi i operimit eshte i njejte, pra cdo etape si dhe shkarkimet e masat parandaluese dhe zbutese te shkarkimeve e ndikimeve jane te njejta.

### 4.3. Zhurma dhe vibrime

Zhurma do te krijohet si pasoje e proceseve te punes te listuara me poshte:

- Makinerite transportuese te mbetjeve gjate fazes se operimit te qelizes shtese te lendfillit te mbetjeve urbane;
- Makinerite qe do te realizojne ngjeshjen/ kompaktimin e mbetjeve gjate fazes se operimit te qelizes shtese te lendfillit te mbetjeve urbane.

Zhurma (ashtu sikurse dhe ujerat siperfaqesore, nentokesore, ajri - pluhurat, gazet) do te monitorohet sikurse monitorohet Aktualisht per qelizen ekzistuese (pika 13) e lendfillit te mbetjeve urbane monitorimi kryhet sipas kushtit 9 te Lejes se Mjedisit te Tipit A me PN-0762-08-2021, ku nuk ka patur tejkalime te nivelit te percaktuar ne lejen e mjedisit dhe ne legjislacionin kuader ne fuqi.

### 4.4. Prodhimi i mbetjeve

*Gjate fazes se operimit te qelizes shtese* te lendfillit te mbetjeve urbane, mbetjet urbane do te konsiderohen lende te para, duke qene se do te depozitohen ne lendfill.

Mbetjet urbane qe do te pranohen ne qelizen shtese te lendfillit (pika 13, pajisur me lejen e mjedisit te tipit A me PN-0762-08-2021) do te jene ekzaktesisht sipas Shtojces 4.1 “Menaxhimi i mbetjeve” te Lejes se Mjedisit te Tipit A me PN-0762-08-2021, e cila do te rishikohet per te pasqyruar shtimin e kapacitetit te depozitimit te mbetjeve urbane.

Nga aktiviteti i depozitimit te mbetjeve urbane ne lendfill (ku mbetjet urbane konsiderohen si lende e pare), gjenerohen 2 kategori mbetjesh:

1- Mbetjet e riciklueshme, te cilat diferencohen ne kapanonin e selektimit te mbetjeve dhe nuk depozitohen ne lendfill, por terhiqen nga agjente tregtare ose operatore te licencuar per trajtimin e metejshem te tyre, si dhe
2- Ujerat e ndotura qe gjenerohen nga mbetjet. Trajtimi i ketyre ujerave konsiston ne gumbullimin ne vaska me ane te sistemit te pompave te instaluara dhe me mjete te posacme do te transportohen nga shoqeria Gant Construction shpk ne impiantin e trajtimit te ujerave te shoqerise Brema Ambiente shpk sipas

- Te gjitha automjetet dhe pajisjet duhet te pajtohen ne cdo kohe me standardet dhe rregullat perkatese shqiptare per emetimet.
- Pajisjet duhet te inspektohen ne menyre te menjehershme nese dyshohet per demtime ose mungese riparimi.
- Pajisjet qe gjenden se jane te pariparuara nuk mund te perdoren per aktivitetet e projektit deri sa problemi te korrigjohet.
- Te gjitha automjetet dhe pajisjet duhet t’i nenshtrohen servisit ne perputhje me udhezimet e mirembajtjes se prodhuesit.
- Automjetet dhe pajisjet mund te ndryshojne vetem ne perputhje me udhezimet e prodhuesit per te permiresuar efikasitetin e shperthimit dhe reduktuar emetimet.

***Automjetet/ Menaxhimi i Transportit*** Te gjitha automjetet qe lidhen me projektin dhe qe perdoren nga shoqeria zbatuese e projektit, duhet te pajtohen me normat e meposhtme te krijuara per kalim te sigurt dhe mbrojtje mjedisore:

- Te pajtohen me te gjitha ligjet dhe rregullat kombetare dhe lokale perkatese per transportin dhe mirembajtjen e automjeteve.
- Te sigurojne qe shoferet jane te licencuar per automjetin qe jane duke operuar.
- Te inspektohet dhe t’u behen rregullisht sherbimet e automjeteve per te garantuar nje performance optimale qe zvogelon krijimin e emetimeve, zhurmave dhe dridhjeve.
- Te menjanohen automjetet qe kane rrjedhje nga servisi deri sa defekti te rregullohet, per te parandaluar ndotjen e tokes dhe ujerave.
- Te kryejne mirembajtje te automjetit dhe lajne makinat ne hapesira te pershtatshme te krijuara posacerisht,qe ujerat e ndotur te mos shkarkohen ne mjedis.
- Te zhvillojne dhe te pajtohen me procedurat specifike per ngarkimin, transportimin dhe shkarkimin e materialeve te rrezikshme dhe toksike.

- Te vendosin kufizime te shpejtesise per te gjitha automjetet. Kufizimet e shpejtesise duhet te krijohen per te gjitha zonat ku operojne automjetet e projektit dhe duhet te specifikohen per kushte te ndryshme drejtimi, lloje rrugesh dhe lloje automjetesh. Duhet te krijohen gjithashtu masa te vecanta per drejtimin afer shkollave dhe receptoreve social te tjere te ndjeshem.

Ne vijim paraqitet ne menyre te detajuar sistemi i kaptimit te biogazit, i cili do te nise instalimin ne momentin qe nga mbetjet urbane te depozituara do te clirohet sasi e mjaftueshme e metanit (biogazit):

## ➢ Sistemi i kaptimit te biogazit

Impianti i nxjerrjes se biogazit do te realizohet duke perdorur kriterin e shpimit pas arritjes se kuotes maksimale mbushese. Kjo zgjidhje eshte preferuar ne krahasim me puset e ndertuara gjate realizimit pasi me efikase dhe me pak te kushtueshem per t'u realizuar. Gjithashtu mbushja e sektoreve te vecante lejon nje mbushje te shpejte te vete sektoreve qe dora dores pajisen me sisteme te nxjerrjes se biogazit.

Operacionet e shpimit te puseve u be me sistemin antideflagrant me diameter 1000 mm, brenda vrimes do te vendoset nje kafaz metalik rrethor i realizuar me rrjete te salduar me sycka 10x10 dhe me diameter 1000 mm. Ne brendesi do te vendoset tubi i kaptimit te biogazit prej PEAD me vrime PN 160, se fundi tubi i ndermjetem kafazi metalik tubi prej PEAD do te mbushet me zhavorr. Nje vemendje e vecante do t'i kushtohet mbylljes se kokes se pusit. Puset e realizuara ne trupin e pikes se grumbullimit te mbetjeve do te lidhen nga siper me nje tubacion qe nga ana e tij drejtohet nga nje sistem aspirimi: percaktohet nje depresion ne koke te secilit pus qe ushtron veprimin e tij te terheqjes se biogazit ne nje zone influence me forme cilindrike. Depresioni i aplikuar, me kollone uji prej disa centimetrash, nuk do te lejoje futjen e mbetjeve ne zonen qe vjen nga terreni perreth pikes se grumbullimit te mbetjeve. Pasi realizohen pas perfundimit te pikes se grumbullimit te mbetjeve, puset do te behen 80% me te thelle. Nuk ekzistojne tregues per distancat minimale mes puseve por, ne menyre evidente, nuk mund te jene me afer se 20÷30 metra si per arsye ekonomike ashtu edhe per te mos u bere nje pengese e tepert per operacionet e administrimit ne fazen e kultivimit dhe pas mbylljes. Realizimi i puseve te nxjerrjes se biogazit gjate kultivimit te pikes se grumbullimit te mbetjeve pervec se nuk eshte i mundur teknikisht nuk prodhon asnje avantash mjedisor. Sistemi i kaptimit te biogazit do te realizohet ne parcelat e pikes se grumbullimit te mbetjeve qe mund te presin mbetje me substance organike qe gjenerojne produkte aeroforme, per rastin ne shqyrtim mbetjet e ngurta urbane.




**Figura 29 Skema treguese e kaptimit te biogazit – Qeliza shtese e lendfillit te mbetjeve urbane**

**Sistemi i kaptimit te gazit eshte parashikuar qe ne qelizen e pare dhe po ketij sistemi eshte shtuar edhe kapaciteti i qelizes te re, sikurse verehet edhe ne skemen e mesiperme.**

### 8.1.2. MASAT ZBUTESE PER REDUKTIMIN E NDIKIMEVE NE TOKE

Per sa i perket fazes se operimit nuk gjenerohen mbetje te rrezikshme qe mund te ndikojne ne cilesine e tokes.

- Kompania te percaktoje nje vend te caktuar dhe te pajisuar me kosha per grumbullimin e mbetjeve urbane.
- Cdo lende ndihmese do e magazinohet ne kushte optimale ne menyre qe te mos ndodh asnje lloj shakrkimi aksidental ne toke.
- Gjate perimetrit se siperfaqes ku do te operoje kompania te hapen kanale kulluese ne menyre qe te sistemohen ujerat siperfaqesore te sheshit dhe te kontrollohet cdo lloj derdhje brenda siperfaqes se projektit.

### 8.1.3. MASAT ZBUTESE PER NDIKIMET NGA GJENERIMI I ZHURMAVE

Per te trajtuar ceshtjet e zhurmes dhe vibracioneve, Kompania do te mundesoje mirembajtje dhe monitorim per burimet kryesore te emetimit te zhurmave dhe vibrimeve (si psh. per gjeneratoret, etj.), do te shmange operacionet gjate nates dhe do te perdore zbutje specifike per pajisjet e zhurmshme.

Pavaresisht masave per reduktimin dhe menjanimin e zhurmave, nje pjese e zhurmave mund te jene te pashmangshme, si psh. zhurma e makinerive, kamionave gjate transportimit te mbetjeve inerte dhe punimeve te ndertimit. Kompania do te marre masa lehtesuese per te permbushur normat e lejuara per zhurmat tek receptoret sensitive (banesat prane Zones se Trajtimit te Mbetjeve Tirane), nepermjet barierave mbrojtes si dhe kufizimit te shpejtesise se levizjes te kamioneve. Ky element do te jete me i ndjeshem per punonjesit te cilet duhet te pajisen me pajisje personale mbrojtese per reduktimin e efekteve te zhurmave ne se ato rezultojne te jene mbi normat e lejuara.

### 8.1.4. MASAT ZBUTESE PER REDUKTIMIN E NDIKIMEVE NE UJERAT SIPERFAQESORE

Duke qene se lendfilli i mbetjeve urbane (pika 13) eshte i pajisur me leje mjedisi tip A, me PN-0762-08-2021 dhe tashme eshte drejt ezaurimit te fazes se operimit, tubacionet/ puseta/ pompa dhe gjithe infrastruktura mbeshtetese e lidhjes se qelizes ekzistuese te lendfillit te mbetjeve urbane (pika 13) eshte vendosur qe para pajisjes me leje mjedisi. Ne te njejten menyre do te pergatitet dhe qeliza shtese per zgjerimin e kapacitetit te lendfillit te mbetjeve urbane (pika 13) per fazen e operimit, pra rrjeti i tubacioneve/ pusetave/ pompave do te jete shtese e rrjetit te vendosur tashme per qelizen ekzistuese (piken 13).

Aktualisht, ujerat e ndotura qe gjenerohen nga Zona e Trajtimit te Mbetjeve Tirane (konkretisht nga lendfilli i mbetjeve urbane, pika 13 grumbullohen ne vaska me ane te

sistemit te pompave te instaluara dhe me mjete te posacme do te transportohen nga shoqeria Gant Construction shpk ne impiantin e trajtimit te ujerave te shoqerise Brema Ambiente shpk sipas Aktmarreveshjes Nr. 940 Prot, Dt. 09.10.2024 me objekt: "Per transportimin dhe trajtimin/asgjesimin e mbetjeve te gjeneruara me kod 19 07 02(rrjedhje nga landfill-et qe permbajne substanca te rrezikshme)", ku do te kalojne procesin e asgjesimit. Kjo do te kyhet deri ne perfundimin e ndertimit te Impiantit te trajtimit te ujerave te ndotura ne Z.T.M.T. Ujerat e ndotura ne kete vaske vijne me nje sistem pompimi nga landfilli i mbetjeve te ngurta urbane. Gjithashtu ne vasken e pare te impiantit te trajtimit te ujerave grumbullohen edhe ujerat qe vijne nga larja e rrugeve. Per faktin se impianti i trajtimit te ujit nuk ka perfunduar, deri ne perfundimin e tij, si zgjidhje alternative duke mbajtur ne kontroll sasine e ujerave te ndotura te gjeneruara, behet injektimi i ketyre ujerave ne landfillin e mbetjeve urbane.
Pasi vaska e pare mbushet deri ne kapacitetin maksimal, me ane te nje sistemi pompimi ujerat e ndotura injektohen serish ne landfillin e mbetjeve urbane. Projekti ka parashikuar realizimin e 6 vaskave te njetrajtshmerimit me kapacitet nominal prej rreth 15.000 $m^3$. Nga ky proces ujerave te ndotura do t'i duhen dite apo jave qe te rikthehen serish ne vasken e pare.

Pas perfundimit te ndertimit te Impiantit te Trajtimit te Ujerave te Ndotura, do te kryhet aplikimi per pajisje me leje mjedisi, bazuar ne Ligjin 10448/2011 "Per lejet e mjedisit", i ndryshuar, si dhe do te kryhet aplikimi per pajisje me lejen perkatese per shkarkimet ne trupat ujore siperfaqesore nga Agjencia e Menaxhimit te Burimeve Ujore, bazuar ne VKM nr. 550/2020 "Per miratimin e formulareve te kerkeses per miratimin, ne parim, per dhenien me koncesion te perdorimit te burimit ujor, e lejes/autorizimit per perdorim burimi ujor, veprimtari ndertimore ne brigje, veprimtari ne shtratin e burimit ujor, shkarkime te lengshme, perdorimin dhe riperdorimin e ujerave te perdorura, te ndotura, te dokumenteve shoqeruese, te procedures se shqyrtimit e te vendimmarrjes, te formateve te lejes, te autorizimit, te kushteve te posacme dhe te afateve te vlefshmerise se tyre".

Operimi i ketij lloj projekti gjeneron ujra te ndotura (perkolato/ shllam/ leksiviate), te cilat do te trajtohen ne Impiantin e Trajtimit te Ujerave te Ndotura (pjese e projektit te Zones se Trajtimit te Mbetjeve Tirane). Ujerat do te grumbullohen me ane te pompave e do te percillen me ane te tubacioneve per te impianti i trajtimit te ujerave te ndotura dhe per kete arsye nuk ndikon ne menyre te drejte per drejte ne ujerat siperfaqesore.

- Kompania gjate fazes se operimit te menaxhoje ujerat urbane ne rrjetin e kanalizimit te zones.
- Te sistemoje ujerat siperfaqesore te sheshit ne te cilin do te operoje.
- Te mos depozitoje/ hedhe asnje lloj mbetje ne mjedisin prites.

Impianti i Trajtimit te Ujerave te Ndotura do te funksionoje ne baze te nje paneli te automatizuar, i cili monitoron mbarevajtjen e proceseve te trajtimit te ujerave dhe

sinjalizon ne rast avarie/ incidentesh. Gjithashtu, do te kryhen dhe analizat nga laborator i akredituar mjedisor per te siguruar cilesine e ujit te purifikuar.

*Ne vijim paraqiten skicat perkatese te Impiantit te Trajtimit te Ujerave te Ndotura:*




**Fig. Procesi i trajtimit te ujerave te ndotura**




**Fig. Planimetria e Impiantit te Trajtimit te Ujerave te Ndotur (Faza 1)**

#### 8.1.5. MASAT ZBUTESE PER NDIKIMET NGA MBETJET

Ky projekt nuk gjeneron mbetje, por gjate fazes ses operimit, para se te cohen ne qelizen shtese (per te cilen po behet ky aplikim), perfshire qelizen ekzistuese qe eshte drejt ezaurimit te kapacitetit depozitues te mbetjeve, mbetjet do te selektohen fillimisht ne kapanonin e diferencimit. Ne kapanon, ashtu sikurse eshte shpjeguar dhe ne kapitullin 1 te ketij raporti, diferencohen rrymat e mbetjeve te riciklueshme, te cilat me pas terhiqen nga agjente tregtare ose operatore te licencuar per riciklimin e tyre.

Gjithashtu, bazuar ne lejen e mjedisit te tipit A, me PN-0762-08-2021 (e cila do te rishikohet per te reflektuar zgjerimin e kapacitetit), cdo 3 muaj raportohet ne Agjencine Kombetare te Mjedisit, per mbetjet urbane qe pranohen ne Zonen e Trajtimit te Mbetjeve Tirane dhe mbetjet e riciklueshme qe dalin nga procesi diferencimit te tyre. Raportimi i fundit lidhur me zbatimin e kushteve te lejes se mjedisit tip A me PN-0762-08-2021 eshte dorezuar ne Agjencine Kombetare te Mjedisit me ane te shkreses me nr. 2207 prot., date 22.02.2024 (reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit).

Mbetjet urbane do te menaxhohen brenda Zones se Trajtimit te Mbetjeve Tirane sipas kerkesave ligjore. Ne asnje rast nuk do te lejohet grumbullimi i mbetjeve ne natyre apo ne vende jo te miratuara per grumbullimin dhe depozitimin e tyre.

Gjithashtu, gjate fazes se operimit te qelizes shtese per lendfillin e mbetjeve urbane (pika 13) do te gjenerohen dhe ujra te ndotura, trajtimi i te cilave eshte pershkruar ne menyre te detajuar ne paragrafin me siper (7.1.4).

#### 8.1.6. MASAT ZBUTESE PER NDIKIMET MBI POPULLSINE LOKALE

Masat zbutese te parashikuara per zvogelimin e pluhurit, mbrojtjen e ujit dhe tokes, parandalimin e shkarkimeve, etj. do te parandalojne dhe kufizojne cdo ndikim negativ. Kompania do te monitoroje ndikimet sociale qe kane lidhje me projektin dhe do te parashikoje masa zbutese shtese nese nevojitet dhe do te mundesoje identifikimin e hershem dhe rregullimin e menjehershem per ata qe besojne se jane demtuar ose shqetesuar nga operacionet e saj.

### 8.2. PLANI I MONITORIMIT MJEDISOR

Plani i Monitorimit Mjedisor eshte hartuar qe te monitoroje operimin dhe masat zbutese te percaktuara dhe ndikimet qe lidhen zhvillimin e projektit te qelizes shtese te lendfillit ekzistues te mbetjeve urbane, te pajisur me Leje Mjedisi te tipit A (PN-0762-08-2021). Keto procedura referohen ne kete VNM, dhe formojne nje pjese te regjimit te menaxhimit sipas se cilit do te ndermerret projekti.

Qellimi i monitorimit mjedisor eshte qe te siguroje te dhena nepermjet te cilave te vleresohet nese zhvillimi i veprimtarise eshte ne perputhje me ligjet dhe standardet mjedisore qe lidhen me te, per te vleresuar shkallen e ndikimit (nese ka), si dhe per te vleresuar performancen mjedisore te zbatimit te projektit.

Monitorimi i mjedisit eshte detyrim ligjor, menyra, frekuenca dhe elementet e monitorimit jane te ndryshem per veprimtari te ndryshme. Ne vijim do te paraqesim elementet qe duhet te monitoroje subjekti gjate funksionimit te impiantit. Elementet e tjere apo percaktimi i frekuencave te monitorimit do te percaktohet ne akt miratimin e lejes mjedisore per kete veprimtari.

**Tabela 4 Plani i monitorimit mjedisor**

| Nr. | Monitorimi | Parametrat qe do te monitorohen gjate fazes pergatitore (instalimi i teknologjise se lendfillit) per operim te qelizes shtese per zgjerimin e kapacitetit te lendfillit te mbetjeve urbane i pajisur me Leje Mjedisi te tipit A (PN-0762-08-2021) | Frekuenca |
|---|---|---|---|
| 1 | Cilesia e Ajrit | PM10, TSP, $SO_2$, NOx, CO, | Cdo 6 muaj |
| 2 | Emetimi i zhurmave | Niveli i zhurmave ne dB | Cdo 6 muaj |
| 3 | Cilesia e ujerave siperfaqesore | pH, TSS, DO BOD, COD | Cdo 6 muaj |
| 4 | Monitorim i zbatimit te kushteve te Vendimit per VNM Paraprake | Monitorim te te gjithe kushteve dhe detyrimeve te percaktura ne Vendimin per VNM Paraprake | Cdo 6 muaj |

***Shenim:*** **Per parametrat qe do te monitorohen gjate fazes se operimit do te kryhet aplikimi per rishikimin e kushteve te Lejes se Mjedisit te Tipit A me PN-0762-08-2021 sipas percaktimeve te VKM 419, date 25.06.2014** "Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A, B dhe C, per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit, si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja", te ndryshuar, perkatesisht tek Kreu V "Ndryshime ne funksionimin e instalimeve te tipit A dhe te tipit B dhe rishikimi i kushteve te lejeve ekzistuese", SEKSIONI 1 "Ndryshimi i propozuar ne funksionimin e nje instalimi te tipit A dhe te tipit B".

Shoqeria “Integrated Energy BV SPV” Sh.p.k. eshte e pajisur me Lejen e Mjedisit te Tipit A me PN-0762-08-2021 per lendfillin e mbetjeve urbane (pika 13), ne baze te se ciles kryhet monitorimi i gjendjes se mjedisit.

## 8.3. INFORMACIONI LIDHUR ME ZBATIMIN E KUSHTEVE TE LEJES SE MJEDISIT TE TIPIT A ME PN-0762-08-2021

Informacioni lidhur me zbatimin e kushteve te Lejes se Mjedisit te Tipit A me PN-0762-08-2021 per instalimin “Lendfill i mbetjeve (D1) duke perjashtuar lendfillin e mbetjeve inerte” te cilat do vijoijne te zbatohen edhe pas rishikimit te kushteve te kesaj lejeje, qe do perfshije edhe qelizen shtese per lendfillin e mbetjeve urbane (pika 13) jepet ne vijim:

- **Kushti 1.3**

Aplikimi per Vleresim te Ndikimit ne Mjedis me AN210220240004, po kryhet per ndryshimin e kapacitetit te instalimit “Lendfill i mbetjeve (D1) duke perjashtuar lendfillin e mbetjeve inerte”. Referuar nenit 8, germa ‘b’ te Ligjit nr. 10440, date 07.07.2011, “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis”, te ndryshuar, ku citohet perkatesisht:
*“Projektet qe i nenshtrohen vleresimit paraprak te ndikimit ne mjedis jane:*
*b) cdo ndryshim a shtese ne projektet e listuara ne shtojcen I apo II, te licencuara paraprakisht, qe mund te shkaktoje efekte te rendesishme negative mbi mjedisin”.*
Ne shkresen me nr. 4391/3 prot., date 28.07.2022 (reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit), nga ana e Agjencise Kombetare te Mjedisit eshte percaktuar procedura qe duhet te ndiqet nga shoqeria “Integrated Energy BV SPV” Sh.p.k. per ndryshimin e kushteve te Lejes se Mjedisit te Tipit A me PN-0762-08-2021.
Bazuar ne kete shkrese, pas perfundimit te procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis me AN210220240004, shoqeria “Integrated Energy BV SPV” Sh.p.k. do te kryeje proceduren e rishikimit te Lejes se Mjedisit Tipa A me PN 0762-08-2021.

Ne zbatim te kushtit 1.3 te lejes se mjedisit tip A me PN-0762-08-2021 (e cila do te rishikohet per zgjerimin e kapacitetit te qelizes ekzistuese te mbetjeve urbane), shoqeria “Integrated Energy BV SPV” Sh.p.k. ka marre dhe vendimin nr. 115, date 01.03.2024 “Per miratimin e ndryshimeve ne lidhje me funksionimin dhe ndryshimet e konsiderueshme ne lidhje me instalimin”, i cili paraqitet ne vijim.

INTEGRATED ENERGY

"Integrated Energy BV SPV" sh.p.k.
NUIS: L72031013B
Adresa: Vaqarr, Sharrë, Zona Kadastrale nr. 3321
Indeks harte: K-34-100 (25-C)
Tiranë

**VENDIM**

**Nr. 115, datë 01.03.2024**

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË LIDHJE ME FUNKSIONIMIN DHE NDRYSHIMET E KONSIDERUESHME NË LIDHJE ME INSTALIMIN**

Bazuar në Vendimin nr. 95, datë 28.07.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, miratuar me Urdhrin nr. 47(87-2023-225), datë 10.10.2023, të Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; Urdhrin e Kryeadministratorit të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara nr. 482, datë 31.07.2023 "Për Emërimin e administratorit për pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara", nëpërmjet të cilit emërohet z. Arjan Baci si Administrator i pasurive të sekuestruara me Vendimin nr. 95, datë 28.07.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; Ligjin Nr. 34/2019 "Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara", ndryshuar me ligjin nr. 19/2020, datë 5.3.2020; Situatës të vështirë për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane në Zonën e Trajtimit të Mbetjeve Tiranë; Vlerësimit teknik të kapacitetit aktual të lendfillit ekzistues të mbetjeve të ngurta urbane (pika nr. 13) i pajisur me leje mjedisi tipi A (PN-0762-08-2021); Kërkesës së stafit teknik për shtimin e kapacitetit të lendfillit të mbetjeve të ngurta urbane (pika nr. 13) i pajisur me leje mjedisi tipi A (PN-0762-08-2021):

**VENDOSI:**

1. Miratimin e ndryshimit në lidhje me funksionimin dhe ndryshimet e konsiderueshme në lidhje me instalimin lendfill i mbetjeve të ngurta urbane (pika nr. 13) i pajisur me leje mjedisi tipi A (PN-0762-08-2021), që mund të çojnë në një ndryshim në natyrën e shkarkimeve ose rritje të tyre, në sistemin e pakësimit të shkarkimeve, në lëndën djegëse, lëndët e para dhe materialet ndihmëse, produktet ose gjenerimin e mbetjeve, në menaxhimin e instalimit dhe kontrollit.
2. Për përmbushjen e kërkesave të pikës 1 të këtij Vendimi, të ndiqen procedurat e mëposhtme:
   a. Vijimin e aplikimit për procedurën së vlerësimit të ndikimit në mjedis për qelizën shtesë të mbetjeve të ngurta urbane, me qëllim shtimin e kapacitetit të landfillit të mbetjeve urbane (pika nr. 13) i pajisur me leje mjedisi tipi A (PN-0762-08-2021);
   b. Vijimin e aplikimit për pajisje me leje ndërtimit të qelizës shtesë të mbetjeve të ngurta urbane, me qëllim shtimin e kapacitetit të landfillit të mbetjeve urbane (pika nr. 13);

e-mail: info@iebv.com.al cel. +355(0)686082840

c. Vijimin e punimeve për përfundimin e ndërtimit të “Qeliza shtesë e objektit 13 (landfilli i mbetjeve të ngurta urbane)”;

d. Vijimin e aplikimit për ndryshimin e lejes së mjedisit të tipit A (PN-0762-08-2021) që kjo shoqëri posedon për pikën 13 “Landfilli i Mbetjeve të Ngurta Urbane”, me qëllim që kësaj leje mjedisi t'i shtohet dhe kapaciteti i qelizës shtesë “Qeliza shtesë e objektit pika 13 (landfilli i mbetjeve të ngurta urbane)”.

3. Me këtë vendim të njihen të gjithë punonjësit e shoqërisë.

4. Kontrolli i zbatimit të këtij vendimi kryet nga Drejtori i Shërbimeve Operacionale.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shoqëria
“INTEGRATED ENERGY BV SPV” SH.P.K.
Administrator
Arjan BACI

L72031013B
Integrated Energy BV SPV
-shpk-
Tirana - Albania

- **Kushti 14.6**

Referuar VKM nr. 452/2012 “Per lendfillet e mbetjeve”, te ndryshuar, shoqeria “Integrated Energy BV SPV” Sh.p.k. ka dorezuar “Planin e mbylljes dhe rehabilitimit te instalimit” me ane te shkreses me nr. 3115 prot., date 20.04.2022 (reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit). Plani do te zbatohet pasi qeliza shtese e lendfillit ekzistues te mbetjeve urbane (pika 13) do te jete pajisur me dokumentacionin perkates per fillimin e fazes se operimit, si Leje Mjedisi Tip A (PN-0762-08-2021) e rishikuar dhe Leje Ndertimi e rishikuar. Gjithashtu, kapsulimi i plote do te perfundohet vetem pasi lendfilli i mbetjeve urbane (pika 13) dhe qeliza shtese per zgjerimin e lendfillit te mbetjeve urbane te kene perfunduar fazen e operimit dhe kapsulimin ne vecante te tyre.

- **Kushti 1.5.4**

*“Te jene marre te gjitha masat e nevojshme per zbatimin e kushteve te Lejes se Ndertimit nga Keshilli Kombetar i Territorit (KKT), Nr. 756/8, date 24.11.2020 per*

*objektin "Ndertimi i Landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese" me vendndodhje ne Bashkine Tirane, Faza I, sipas Vendimit nr. 14, date 17.05.2019 te Keshillit Kombetar te Territorit."*

- **Kushti 1.5.5**

*"Te jene marre te gjitha masat e nevojshme per zbatimin e kushteve te Lejes per ndryshim projekti gjate ndertimit nga Keshilli Kombetar i Territorit (KKT), Nr. 53/3, date 25.02.2021 per objektin "Ndertimi i Landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese" me vendndodhje ne Bashkine Tirane, Faza I, sipas Vendimit nr. 52, date 28.12.2020 te Keshillit Kombetar te Territorit."*

Per sa i perket kushteve 1.5.4 dhe 1.5.5 te cituar me siper, shoqeria "Integrated Energy BV SPV" Sh.p.k. eshte e pajisur me Lejen e Ndertimit Nr 756/8, date 24/11/2021 per objektin: "Ndertimi i Landfillit, Inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese", me vendndodhje ne Bashkine Tirane", Faza 1, sipas Vendimit nr. 14, date 17.05.2019, te Keshillit Kombetar te Territorit.

Leja e Ndertimit e cituar me siper eshte ndryshuar me ane te Lejes Nr. 53/3, date 25.02.2021 per objektin "Ndertimi i Landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese" me vendndodhje ne Bashkine Tirane, Faza I, sipas Vendimit nr. 52, date 28.12.2020 te Keshillit Kombetar te Territorit.

**Lejet e Ndertimit te cituara me siper gjenden ne Shtojcen 4, bashkelidhur ketij dokumenti.*

Projekti "Per ndertimin landfilli, inceneratori dhe rehabilitim i venddepozitimeve ekzistuese tirane dhe prodhimin e energjise elektrike, Sharre – Tirane" konsiston ne realizimin e zgjidhjeve mjedisore te mbetjeve urbane.

Ky projekt investimi ka nje shtrirje ne siperfaqe prej 1,067,095 $m^2$.

Sipas "Lejes se Ndertimit" te miratuar me vendim te KKT nr.14 dt 17/05/2019 dhe me perditesim e fundit ne "Leje Ndertimi" te miratuar me vendim te KKT nr.52 dt 28/12/2020, ne kete projekt jane te parashikuar per t'u ndertuar 19 objekte.

Punimet per realizimin e ketyre objekteve jane te ndara ne Lot-e (kapituj) ne Preventivin e Punimeve te kontrates. Keto Lot-e (nga shkronja "A" deri te "Q") konsistojne ne zberthim te "Zerave te Punimeve" sipas Objekteve perkates ne nen-pikat e tyre.

- Venddepozitimi i mbetjeve ngurta urbane – Objekti 13 (LOT B).

Ky objekt ne planimetrine e Lejes se Ndertimit eshte objekti Nr.13 dhe eshte pjese e fazes se pare te ndertimit.

Punimet e para te ketij objekti kane filluar ne Tetor 2019, i mbajtur edhe me procesverbal "Akt – Piketim" dt. 14.10.2019 (Shtojca 5.2 bashkelidhur ketij raporti), edhe pse njoftimi per fillim punimesh ne sistem eshte derguar me 04/12/2020 dhe njoftimi me leter drejtuar Autoritetit Kontraktor eshte derguar dt. 11.12.2020 (Shtojca 5.1 bashkelidhur ketij raporti),, e gjitha kjo per arsye te voneses se zbardhjes se lejes.

Punimet per ndertimin e ketij objketi jane realizuar sipas Kushteve Teknike te Ndertimit, Specifikimeve Teknike te Projektit dhe te kushteve te Lejes se Ndertimit Nr 756/8, date 24/11/2021 per objektin: "Ndertimi i Landfillit, Inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese", me vendndodhje ne Bashkine Tirane", Faza 1, sipas Vendimit nr. 14, date 17.05.2019, te Keshillit Kombetar te Territorit.

Ky objekt ka perfunduar punimet ne Dhjetor 2020 dhe eshte bere "Kolaudim Pjesor" me 12.06.2021 (Shtojca 5.5 bashkelidhur ketij raporti), ku raporti i kolaudimit te ketij lendfilli eshte ne faqet 43-54 te relacionit.

**Dokumentat e cituar me siper gjenden ne Shtojcen 5 bashkelidhur ketij raporti.*

- **Kushti 8**

Bazuar ne:

o Ligjin 10463/2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", i ndryshuar;
o VKM nr. 452/2012 "per lendfillet e mbetjeve", te ndryshuar;
o VKM Nr. 229/2014 "Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme dhe te dokumentit te transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme"

Lidhur me menaxhimin e mbetjeve, raportohet cdo 3 muaj ne Agjencine Kombetare te Mjedisit per mbetjet urbane te cilat pranohen ne Zonen e Trajtimit te Mbetjeve Tirane dhe gjithashtu per mbetjet e riciklueshme te cilat diferencohen ne kapanonin e selektimit dhe me pas terhiqen nga agjente tregtare. Shkresat percjellese me ane te te cilave raportimet mbi menaxhimin e mbetjeve jane percjelle ne Agjencine Kombetare te Mjedisit jane cituar ne paragrafet ne vijim.

- **Kushti 9**

Lidhur me nivelin e zhurmes se instalimit raportohet cdo 3 muaj ne Agjencine Kombetare te Mjedisit, ku shkresat percjellese te raporteve jane listuar ne vijim.

- **Kushti 10**

Lendet e para ne qelizen shtese te lendfillit ekzistues te mbetjeve urbane (Pika 13), jane mbetjet urbane. Ashtu sikurse eshte shpjeguar me siper, te dhenat mbi menaxhimin e mbetjeve (pra regjistri dhe formularet e transferimit te mbetjeve) percillen ne shpeshtesi 3 mujore ne Agjencine Kombetare te Mjedisit.

Per sa i perket energjise elektrike te instalimit, duke qene se instalimi ne fjale eshte lendfill, energjia elektrike eshte e nevojshme vetem per funksionimin e pompave qe terheqin ujerat e ndotura nga lendfilli. Gjithsesi, raporti i auditimit te energjise per Zonen e Trajtimit te Mbetjeve Tirane (Z.T.M.T.), pjese e se ciles eshte dhe lendfilli

ekzistues i mbetjeve urbane (Pika 13), eshte percjelle ne Agjencine Kombetare te Mjedisit me ane te shkreses me nr. 6444 prot., date 19.08.2022 (reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit).

- **Kushti 11, 12**

Informacioni lidhur me zbatimin e kushteve 11 dhe 12 te Lejes se Mjedisit te Tipit A me PN-0762-08-2021 per instalimin "Lendfill i mbetjeve (D1) duke perjashtuar lendfillin e mbetjeve inerte" jepet ne vijim:

- Me ane te shkreses me nr. 5829 prot., date 22.11.2021 (reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit), jane dorezuar raportet e listuara me poshte:
  - Propozimi per regjistrin e shkarkimit te ndotjes;
  - Programi i Monitorimit te Zhurmes;
  - Programi i Menaxhimit te Mjedisit (me shtojce per objektivat dhe detyrat);
  - Programi i Menaxhimit te Riskut;
  - Raporti i vetemonitorimit per periudhen 20 Gusht – 20 Nentor 2021.

- Me ane te shkreses me nr. 1657 prot., date 04.03.2022 (reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit), jane dorezuar raportet e listuara me poshte:
  - Raporti i vetemonitorimit per periudhen 20 Nentor 2021 – 20 Shkurt 2022;
  - Raportim mbi sasine dhe kodet e mbetjeve te menaxhuara (formularet dhe regjistri sipas VKM Nr. 229/2014 "Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme dhe te dokumentit te transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme");
  - Plan monitorimi i ujerave nentokesore;
  - Deklarim mbi planin e menaxhimit te tretesve organike;
  - Deklarim mbi programin e identifikimit, monitorimit dhe pakesimit te shkarkimeve fluruese ne ajer;
  - Deklarim mbi masat per minimizimin/ reduktimin e emetimeve te amoniakut nga burimi i shkarkimit te squfurit;
  - Deklarim mbi modelin e shperberjes se ajrit te ndotur.

- Me ane te shkreses me nr. 1658 prot., date 04.03.2022 (reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit), eshte dorezuar Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit te Ndotesve per instalimin "Lendfill i mbetjeve (D1) duke perjashtuar lendfillin e mbetjeve inerte" per vitin 2021.

- Me ane te shkreses me nr. 3115 prot., date 20.04.2022 (reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit), jane dorezuar raportet e listuara me poshte:
  - Plan per parandalimin e aksidenteve;

- Plan i mbylljes dhe rehabilitimit te instalimit (Ky plan paraqitet ne zbatim te Kushtit 14 te Lejes se Mjedisit te tipit A te cituar me siper, per periudhen kohore pas perfundimit te fazes operacionale te instalimit).

- Me ane te shkreses me nr. 3976 prot., date 23.05.2022 (reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit), eshte dorezuar Raporti i Vetemonitorimit 20 Shkurt – 20 Maj 2022;

- Me ane te shkreses me nr. 6444 prot., date 19.08.2022 (reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit), jane dorezuar raportet e listuara me poshte:
  - Raporti i vetmonitorimit te gjendjes se mjedisit per periudhen 20 Maj – 20 Gusht 2022;
  - Raporti vjetor 20 Gusht 2021 - 20 Gusht 2022;
  - Raporti i auditimit te energjise.

- Me ane te shkreses me nr. 9513 prot., date 24.11.2022 (reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit), eshte dorezuar Raporti i Vetemonitorimit 20 Gusht – 20 Nentor 2022;

- Me ane te shkreses me nr. 1161 prot., date 20.02.2023 (reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit), jane dorezuar raportet e listuara me poshte:
  - Raporti i vetemonitorimit te gjendjes se mjedisit per periudhen 20 Nentor 2022 – 20 Shkurt 2023;
  - Sasia e mbetjeve te menaxhuara per periudhen 15 Nentor 2022 – 15 Shkurt 2023 sipas kerkesave te VKM nr. 229/2014 “Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme”.

- Me ane te shkreses me nr. 1267 prot., date 22.02.2023 (reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit), eshte dorezuar mandat-pagesa per vitin 2023, per Lejen e Mjedisit te Tipit A me PN-0762-08-2021.

- Me ane te shkreses me nr. 1716 prot., date 09.03.2023 (reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit), eshte dorezuar Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit te Ndotesve per instalimin “Lendfill i mbetjeve (D1) duke perjashtuar lendfillin e mbetjeve inerte” per vitin 2022.
- Me ane te shkreses me nr. 3787 prot., date 22.05.2023 (reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit), jane dorezuar raportet e listuara me poshte:
  - Raporti i vetemonitorimit te gjendjes se mjedisit per periudhen 20 Shkurt – 20 Maj 2023;
  - Sasia e mbetjeve te menaxhuara per periudhen 16 Shkurt – 16 Maj 2023 sipas kerkesave te VKM nr. 229/2014 “Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme” dhe Kushtit 8 te lejes se mjedisit te cituar me siper.

- Me ane te shkreses me nr. 6710 prot., date 23.08.2023 (reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit), jane dorezuar raportet e listuara me poshte:
    - Raporti i vetemonitorimit te gjendjes se mjedisit per periudhen 20 Maj – 20 Gusht 2023;
    - Raporti vjetor 20 Gusht 2022 - 20 Gusht 2023;
    - Sasia e mbetjeve te menaxhuara per periudhen 17 Maj – 17 Gusht 2023 sipas kerkesave te VKM nr. 229/2014 “Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme” dhe Kushtit 8 te lejes se mjedisit te cituar me siper.

- Me ane te shkreses me nr. 9694 prot., date 21.11.2023 (reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit), jane dorezuar raportet e listuara me poshte:
    - Raporti i vetemonitorimit te gjendjes se mjedisit per periudhen 20 Gusht – 20 Nentor 2023;
    - Sasia e mbetjeve te menaxhuara per periudhen 18 Gusht – 17 Nentor 2023 sipas kerkesave te VKM nr. 229/2014 “Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme” dhe Kushtit 8 te lejes se mjedisit te cituar me siper.

- Me ane te shkreses me nr. 2207 prot., date 22.02.2024 (reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit), jane dorezuar raportet e listuara me poshte:
    - Raporti i vetemonitorimit te gjendjes se mjedisit per periudhen 20 Nentor 2023 – 20 Shkurt 2024;
    - Sasia e mbetjeve te menaxhuara per periudhen 18 Nentor 2023 – 18 Shkurt 2024 sipas kerkesave te VKM nr. 229/2014 “Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme” dhe Kushtit 8 te lejes se mjedisit te cituar me siper.

- Me ane te shkreses me nr. 2208 prot., date 22.02.2024 (reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit), eshte dorezuar mandat-pagesa per vitin 2024, per Lejen e Mjedisit te Tipit A me PN-0762-08-2021.

- Me ane te shkreses me nr. 2209 prot., date 22.02.2024 (reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit), eshte dorezuar Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit te Ndotesve per instalimin “Lendfill i mbetjeve (D1) duke perjashtuar lendfillin e mbetjeve inerte” per vitin 2023.

- Me ane te shkreses me nr.5616 prot,date 22.05.2024(reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit), eshte dorezuar raportet e listuara me poshte :

  - Raporti i vetemonitorimit te gjendjes se mjedisit per periudhen 20 Shkurt-2023 – 20 Maj 2024;
  - Sasia e mbetjeve te menaxhuara per periudhen 19 Shkurt 2023 – 19 Maj 2024 sipas kerkesave te VKM nr. 229/2014 “Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme” dhe Kushtit 8 te lejes se mjedisit te cituar me siper.

- Me ane te shkreses me nr.8820 prot,date 22.08.2024 (reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit), eshte dorezuar raportet e listuara me poshte:
  - Raporti i vetemonitorimit te gjendjes se mjedisit per periudhen 20 Maj 2024-20 Gusht 2024;
  - Raportin vjetor te vetmonitorimit te gjendjes se mjedisit 20 Gusht 2023-20 Gusht 2024.
  - Te dhena mbi mbetjet e menaxhuara per preiudhen 20 Maj-20 Gusht 2024 sipas kerkesave te VKM nr.229/2014”Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme “ dhe kushti 8 te lejes se mjedisit te cituar me siper.

- Me ane te shkreses me nr.12442 prot,date 26.11.2024 (reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit), eshte dorezuar raportet e listuara me poshte:
  - Raporti i vetemonitorimit te gjendjes se mjedisit per periudhen 20 Gusht-20 Nentor 2024;
  - Te dhena mbi mbetjet e menaxhuara per preiudhen 20 Gusht 2024-20 Nentor 2024 sipas kerkesave te VKM nr.229/2014”Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme “ dhe kushti 8 te lejes se mjedisit te cituar me siper.

- Me ane te shkreses me nr.2409 prot,date 04.03.2025 (reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit), eshte dorezuar raportet e listuara me poshte:
  - Raporti i vetemonitorimit te gjendjes se mjedisit per periudhen 21 Nentor 2024 - 20 Shkurt 2025;
  - Te dhena mbi mbetjet e menaxhuara per preiudhen 21 Nentor 2024 - 20 Shkurt 2025 sipas kerkesave te VKM nr.229/2014”Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme “ dhe kushti 8 te lejes se mjedisit te cituar me siper.

-

- Me ane te shkreses me nr.2208 prot,date 22.02.2025 (reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit), jane dorezuar raporti si me poshte:
    - Dergim i mandat pagesave te tarifave vjetore te lejeve te mjedisit.

- Me ane te shkreses me nr.2788 prot,date 12.03.2025 (reference e Agjencise Kombetare te Mjedisit), jane dorezuar raporti si me poshte:
    - Raportim mbi rregjistrin e shkarkimit dhe transferimit te ndotesve per vitin 2024.